

# INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SH.A.

Pasqyrat Financiare më

31 Dhjetor 2017

(me raportin e audituesve të pavarur)

---

# Përmbajtja

	Faqe
Raporti i audituesve të pavarur	i-iii
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3-4
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare	5
Shënime shoqëruese mbi Pasqyrat Financiare	
1. Subjekti Raportues	6
2. Bazat e përgatitjes	6
3. Përmbledhje e politikave kontabël	7-17
4. Administrimi i riskut financiar	18-37
5. Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël	38-40
6. Aktivitet dhe detyrimet financiare	41-42
7. Mjete monetare dhe të ngjashme	43
8. Hua dhe paradhënie bankave	43
9. Letra me vlerë të vendosjes	43
10. Letra me vlerë të investimit	44
11. Hua dhe paradhënie klientëve	44
12. Ndërtesa dhe pajisje	45
13. Aktive afatgjata jo-materiale	46-47
14. Aktivitet materiale afatgjata të investuara	47
15. Inventari dhe mjete të tjera	48
16. Detyrime ndaj bankave	48
17. Detyrime ndaj klientëve	49-50
18. Tatimi i shtyrë	51
19. Provizione	51
20. Detyrime të tjera	52
21. Kapitali aksionar dhe primet	52
22. Rezerva ligjore dhe rregullative	52
23. Rezerva të tjera	53
24. Të ardhura nga interesi, neto	53
25. Të ardhura nga komisioni, neto	53
26. Të ardhura të tjera, neto	54
27. Të ardhura/(shpenzime) të tjera operative, neto	54
28. Shpenzime personeli	54
29. Shpenzime të tjera administrative	54
30. Shpenzime tatimi mbi fitimin	55
31. Angazhime dhe të drejta/detyrime të kushtëzuara	56
32. Angazhime qiraje dhe shpenzime qiraje operacionale	57
33. Palët e lidhura	58
34. Ngjarje pas datës së bilancit	59



KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri  
+355(4)2274 524  
al-office@kpmg.com  
kpmg.com/al

## Raporti i Audituesve të Pavarur

Për aksionarët dhe drejtimin e Intesa Sanpaolo Albania Sh.a

### *Opinion*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Intesa Sanpaolo Albania Sh.a ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Bankës më 31 dhjetor 2017, të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### *Baza për Opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### *Informacione të tjera*

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që jepen në raportin vjetor, i përgatitur nga drejtimi në përputhje me Nenin 53 të Ligjit Nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Mbi bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra. Raporti vjetor parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve.

Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se në këtë raport ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen.

### *Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

### *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.



Fatos Beqja  
Auditues Ligjor

KPMG Albania Shpk  
Blvd "Dëshmorët e Kombit"  
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13  
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, 5 mars 2018

**Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a.**

## Pasqyra e Pozicionit Financiar

**Më 31 Dhjetor 2017**

(në mijë Lek)

	Shënime	2017	2016
<b>Aktive</b>			
Mjete monetare dhe të ngjashme	7	22,877,864	27,269,197
Hua dhe paradhënie bankave	8	20,171,066	17,106,968
Letra me vlerë të vendosjes	9	9,423,008	7,251,448
Letra me vlerë të investimit	10	49,110,119	50,729,433
Hua dhe paradhënie klientëve	11	46,557,253	42,542,151
Ndërtesa dhe pajisje	12	2,141,765	1,172,243
Aktive afatgjata jo-materiale	13	528,695	591,902
Aktivet materiale afatgjata të investuara	14	575,318	-
Të drejta tatimore të shtyra	18	174,247	82,092
Të drejta tatimore afatshkurtra		389,883	282,007
Inventari dhe mjete të tjera	15	2,296,937	2,500,378
<b>Aktive gjithsej</b>		<b>154,246,155</b>	<b>149,527,819</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj bankave	16	5,168,783	2,885,233
Detyrime ndaj klientëve	17	127,711,325	125,974,220
Detyrimet tatimore afatshkurtër		-	25,259
Detyrimet tatimore të shtyra	18	148,327	290
Provizione	19	468,695	350,379
Detyrime të tjera	20	1,039,583	786,564
<b>Detyrime gjithsej</b>		<b>134,536,713</b>	<b>130,021,945</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali aksionar	21	5,562,518	5,562,518
Primit e aksioneve	21	1,383,880	1,383,880
Rezerva ligjore dhe rregullative	22	1,825,623	1,825,623
Rezerva të tjera	23	831,461	1,643
Zëra të tjerë përmbledhës	23	714,555	714,555
Fitimi i pashpërndarë		9,391,405	10,017,655
<b>Totali i Kapitalit Aksionar</b>		<b>19,709,442</b>	<b>19,505,874</b>
<b>Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit Aksionar</b>		<b>154,246,155</b>	<b>149,527,819</b>

Shënimet nga faqja 6 deri në 59 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a.**

Pasqyra e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse

**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017**

(në mijë Lek)

	Shënime	2017	2016
Të ardhura nga interesat		4,280,758	4,825,966
Shpenzime për interesat		(522,348)	(817,350)
<b>Të ardhura nga interesi, neto</b>	24	<b>3,758,410</b>	<b>4,008,616</b>
Të ardhura nga komisionet		953,439	910,143
Shpenzime për komisionet		(250,720)	(204,494)
<b>Të ardhura nga komisionet, neto</b>	25	<b>702,719</b>	<b>705,649</b>
Të ardhura të tjera neto	26	417,522	366,342
Shpenzime të tjera operative, neto	27	(270,161)	(278,023)
<b>Të ardhura operative</b>		<b>4,608,490</b>	<b>4,802,584</b>
Rrimarje e zhvlerësimit te mjeteve financiare, neto	11	46,003	398,713
Zhvlerësimi i zërave jashtë bilancit, neto	19	(1,437)	(12,533)
Zhvlerësimi i inventarit	15	(190,287)	(293,553)
Shpenzime personeli	28	(1,135,023)	(1,048,209)
Shpenzime operationale qiraje	32	(159,658)	(164,626)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	12,13,14	(311,101)	(324,257)
Zhvlerësimi i aktiveve materiale afatgjata të investuara	14	(129,773)	-
Amortizimi i përmirësimeve të ambienteve me qira	15	(7,863)	(7,751)
Shpenzime të tjera administrative	29	(733,227)	(614,400)
Provizione për rreziqe dhe shpenzime	19	(50,928)	27,890
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(2,673,294)</b>	<b>(2,038,726)</b>
<b>Fitimi neto para tatimit</b>		<b>1,935,196</b>	<b>2,763,858</b>
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	30	(278,441)	(480,853)
<b>Fitimi për periudhën</b>		<b>1,656,755</b>	<b>2,283,005</b>
<b>Të ardhura të tjera përmbledhëse</b>			
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes, neto nga tatimi mbi fitimin		54,387	1,384
Ndryshimi në vlerën e drejtë të aktiveve materiale afatgjata funksionale, neto nga tatimi mbi fitimin		775,431	-
<b>Të ardhura të tjera përmbledhëse për periudhën, neto</b>		<b>829,818</b>	<b>1,384</b>
<b>Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për periudhën, neto</b>		<b>2,486,573</b>	<b>2,284,389</b>

Shënimet nga faqja 6 deri në 59 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a.**

Pasqyra financiare e ndryshimeve në kapital

**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016**

(në mijë Lek)

	Kapitali aksioner	Primet e aksioneve	Rezerva ligjore dhe rregullative	Rezerva të tjera	Zëra të tjerë përmbledhës	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2016</b>	<b>5,562,518</b>	<b>1,383,880</b>	<b>1,825,623</b>	<b>259</b>	<b>714,555</b>	<b>9,945,745</b>	<b>19,432,580</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	2,283,005	<b>2,283,005</b>
<b>Të ardhura të tjera përmbledhëse</b>							
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes, neto	-	-	-	1,384	-	-	<b>1,384</b>
<b>Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse</b>	-	-	-	<b>1,384</b>	-	<b>2,283,005</b>	<b>2,284,389</b>
<b>Transaksione me aksionerët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar</b>							
Dividendët për aksionerët	-	-	-	-	-	(2,211,095)	<b>(2,211,095)</b>
<b>Totali i kontributeve sipas shpërndarjes tek aksionerët</b>	-	-	-	-	-	<b>(2,211,095)</b>	<b>(2,211,095)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>5,562,518</b>	<b>1,383,880</b>	<b>1,825,623</b>	<b>1,643</b>	<b>714,555</b>	<b>10,017,655</b>	<b>19,505,874</b>

Shënimet nga faqja 6 deri në 59 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.



**Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a.**

Pasqyra financiare e ndryshimeve në kapital (vazhdim)

**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017**

(në mijë Lek)

	Kapitali aksioner	Primet e aksioneve	Rezerva ligjore dhe rregullative	Rezerva të tjera	Zëra të tjerë përmbledhës	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2017</b>	<b>5,562,518</b>	<b>1,383,880</b>	<b>1,825,623</b>	<b>1,643</b>	<b>714,555</b>	<b>10,017,655</b>	<b>19,505,874</b>
Fitimi i vitit						1,656,755	1,656,755
<b>Të ardhura të tjera përmbledhëse</b>							-
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes, neto	-	-	-	54,387	-	-	54,387
Rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale funksionale, neto	-	-	-	775,431	-	-	775,431
<b>Totali i të ardhurave përmbledhëse për periudhën</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>829,818</b>	<b>-</b>	<b>1,656,755</b>	<b>2,486,573</b>
<b>Transaksione me aksionerët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar</b>							
Dividendët për aksionerët	-	-	-	-	-	(2,283,005)	(2,283,005)
<b>Totali i kontributeve sipas shpërndarjes tek aksionerët</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(2,283,005)</b>	<b>(2,283,005)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>5,562,518</b>	<b>1,383,880</b>	<b>1,825,623</b>	<b>831,461</b>	<b>714,555</b>	<b>9,391,405</b>	<b>19,709,442</b>

Shënimet nga faqja 6 deri në 59 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.

**Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a.****Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017**

(në mijë Lek)

	<b>2017</b>	<b>2016</b>
<b>Fitimi neto per vitin</b>	<b>1,656,755</b>	<b>2,283,005</b>
Rregullime për:		
Zhvlërësimi dhe amortizimi	294,703	324,257
Ndryshime në aktivet afatgjata materiale të investuara	(721,489)	-
Zhvlërësimi i aktiveve afatgjata materiale të investuara	146,171	-
Humbja nga pakësimi i ndërtesave dhe pajisjeve (Rrimarrje)/zhvlërësimi i huave dhe paradhënieve për klientët, neto	72,784	56
Zhvlërësimi i inventarit	(46,003)	(398,713)
Të ardhura nga interesi, neto	190,287	293,553
Humbje nga zhvlërësimi i zërave jashtë bilancit, neto	(3,758,410)	(4,008,616)
Shpenzime për tatimet	1,437	12,533
Ndryshime në:	278,441	480,853
Hua dhe paradhënie bankave	(3,064,098)	6,795,969
Hua dhe paradhënie klientëve	(3,392,194)	(1,331,849)
Detyrime ndaj bankave	2,283,550	932,201
Detyrime ndaj klientëve	1,808,924	7,234,443
Inventari dhe mjete të tjera	(94,722)	(716,232)
Detyrime të tjera dhe provizione	344,639	(49,942)
Të drejta tatimore të shtyra	(200,031)	11
Detyrime tatimore të shtyra	26,857	85,453
Interesi i arkëtuar	3,703,854	4,642,223
Interesi i paguar	(594,167)	(919,699)
Tatimi mbi fitimin i paguar	(195,824)	(566,270)
<b>Fluksi neto i parasë nga/(përdorur në) aktivitetet operative</b>	<b>(1,258,536)</b>	<b>15,093,236</b>
<b>Fluksi i parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Blerja e ndërtesave dhe pajisjeve	(232,001)	(160,978)
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	(129,529)	(134,648)
Arkëtimet nga letrat me vlerë të investimit, neto	1,619,313	1,135,137
Blerja e letrave me vlerë të vendosjes	(2,107,575)	(2,794,020)
<b>Fluksi neto i parasë përdorur në aktivitetet investuese</b>	<b>(849,792)</b>	<b>(1,954,509)</b>
<b>Fluksi i parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Dividendë të paguar	(2,283,005)	(2,210,888)
<b>Fluksi i parasë neto nga aktivitetet financuese</b>	<b>(2,283,005)</b>	<b>(2,210,888)</b>
<b>Rritja neto në mjete monetare dhe të ngjashme</b>	<b>(4,391,333)</b>	<b>10,927,839</b>
Mjete monetare dhe të ngjashme më 1 janar	27,269,197	16,341,358
Efekt i ndryshimit të kursit të këmbimit valutor në mjete monetare dhe të ngjashme	-	-
<b>Mjete monetare e të ngjashme më 31 dhjetor</b>	<b>22,877,864</b>	<b>27,269,197</b>

Shënimet nga faqja 6 deri në 59 janë pjesë integrale e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë firmosur në emër të Bankës më 5 mars 2018 nga:


  
 Silvio Pedrazzi  
 Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv


  
 Julian Cela  
 Drejtori i Kontrollit Financiar

# Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

## 1. Subjekti raportues

Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., (më poshtë referuar "Banka"), është një shoqëri e themeluar në Shqipëri. Banka, me seli në Tiranë, në adresën Rruga "Ismail Qemali", nr.27, ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet një rrjeti të përbërë nga 31 degë dhe agjenci në qytete të ndryshme të Shqipërisë: Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Fier, Berat, Gjirokastrë, Korçë, Lushnje, Shkodër, Lezhë, Kavajë, etj., (2016: 31 degë dhe agjenci).

Banka, themeluar në Maj të vitit 1998, u autorizua që të ushtronte aktivitet bankar në Shqipëri. Banka e filloi aktivitetin e vet më 24 shtator 1998.

Në 31 dhjetor 2017 Banka numëronte 576 punonjës (2016: 578).

## 2. Bazat e Përgatitjes

### (a) Deklaratë për përputhshmërinë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të vendosura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Këto pasqyra financiare u autorizuan nga Drejtimi i Bankës më 22 shkurt 2018 dhe u paraqitën për miratim në Këshillin Drejtues.

### (b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me parimin e kostos historike, duke bërë përjashtim vetëm për mjetet financiare të letrave me vlerë të vendosjes dhe ndërtesat e veta në përdorim, të cilat janë të matura me vlerën e drejtë.

### (c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të raportuara në Lek, e cila është në të njëjtën kohë edhe monedha funksionale dhe raportuese e Bankës. Me përjashtim të rasteve kur është specifikisht e shprehur, informacioni financiar i shprehur në Lek është rrumbullakosur në të mjtën më të afërt.

---

*Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017  
(shumat në mijë lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

## 3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vijueshme për të gjithë periudhat e pasqyrave financiare nga Banka, me përjashtim të ndryshimeve të shpjeguara në Shënimin 3(a).

**(a) Ndryshime në politikën kontabël**

Më 31 dhjetor 2017, Banka vendosi të njohë pronat e veta në përdorim me vlerë të drejtë. Ky ndryshim është konsideruar i vullnetshëm dhe bazuar në SNK 8 me kalimin nga metoda e kostos së amortizuar në modelin e rivlerësimit, është kontabilizimi është zbatuar në mënyrë prospektive.

**(b) Monedha e huaj**

Transaksionet e këmbimeve valutore janë kthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e transaksioneve.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit janë këmbyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e këmbimit. Fitimi ose humbja nga këmbimet valutore të zërave monetar është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyer me kursin e këmbimit të ditës në fund të periudhës. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë.

Instrumentet jo-monetare, të cilat janë matur në përputhje me parimin e kostos historike në një monedhë të huaj, janë konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat e konvertimit të cilat rezultojnë nga rikonvertimet njihen në pasqyrën e të ardhurave. Diferencat e konvertimit të cilat rezultojnë nga rikonvertimi i letrave me vlerë të vendosjes njihen tek të ardhurat e tjera përmbledhëse. Diferencat e konvertimit të cilat rezultojnë nga këmbimet valutore me aksionaret regjistrohen direkt në kapitalin aksioner.

**(c) Interesat**

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e të ardhurave me anë të metodës së normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëttimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivitet ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund të jetë një periudhë më e shkurtër) deri në shumën e mbartur të aktivitet ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet me njohjen fillestare të aktivitet dhe detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas. Për llogaritjen e normës efektive të interesit, Banka vlerëson rrjedhën e parasë në të ardhmen duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumenteve financiare, por jo humbjet nga kredia në të ardhmen.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të arkëtuara, shpenzimet për transaksionet, dhe zbritjet ose primet që janë pjesë e normës efektive të interesit. Shpenzimet e transaksionit janë shpenzime shtesë që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes, emetimit ose shitjes së një aktivi ose detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat që paraqiten në pasqyrën e të ardhurave përfshijnë:

- Interesat për aktivin dhe detyrimin financiar të cilat maten me koston e amortizuar llogariten me anë të metodës së normës efektive të interesit; dhe
- Interesat për letrat me vlerë të vendosjes të cilat llogariten me anë të metodës së normës efektive të interesit.

**(d) Komisionet**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit të një aktivi ose detyrimi financiar përfshihen në përcaktimin e normës efektive të interesit (shih pikën (c)).

Të ardhurat e tjera nga komisionet, përfshirë komisionet e shërbimit të llogarisë, komisionet për drejtim investimi, komisionet për shitje dhe vendosje depozite njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve. Nëse angazhimi për një hua nuk pritët të zvogëlojë huan, atëherë komisionet e angazhimit të huas njihen në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së angazhimit.

Shpenzime të tjera nga komisionet lidhen kryesisht me komisionet për transaksione dhe shërbime, të cilat kalojnë në shpenzime në momentin e marrjes së shërbimit të ofruar.

### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **(e) Qiraja**

Përcaktimi nëse një marrëveshje është kontratë qiraje ose përmban një të tillë, bazohet në thelbin dhe përmbajtjen e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim të faktit nëse përmbushja e detyrimeve të marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve të veçantë dhe nëse në marrëveshje parashikohet e drejta për përdorimin e aktivitetit.

Pagesat për qiranë operative njihen në fitim ose humbje me metodën lineare gjatë gjithë kohëzgjatjes së qirasë. Incentivat e qirasë janë njohur si pjesë e shpenzimit total të qirasë, gjatë afatit të qirasë. Incentivat e qirasë të arkëtuara njihen si pjesë integrale e totalit të shpenzimeve për qiranë, gjatë gjithë kohëzgjatjes së qirasë. Nëse Banka, në cilësinë e qiradhënësit, në një kontratë qiraje transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e aktivitetit tek qiramarrësi, atëherë marrëveshja klasifikohet si një qira financiare dhe pagesat e qirasë të barabarta me investimin neto njihen dhe paraqiten në zërin e huave dhe paradhënëve. Të gjitha qiratë e bankës klasifikohen si qira operationale.

#### **(f) Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin përfshijnë tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi e periudhës aktuale dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e të ardhurave me përjashtim kur i referohet zërave të cilët njihen direkt në kapital ose tek të ardhurat e tjera përmbledhëse. Interesat dhe gjokat që lidhen me tatimin mbi të ardhurat, duke përfshirë trajtimet e pasigurta tatimore, njihen sipas SNK 37 Provizionet, Pasivet dhe Aktivitetet e Kushtëzuara.

##### **(i) Tatimi aktual**

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose të arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose shpenzimet për periudhën, dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose të arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme. Tatimi aktual matet duke përdorur normat e taksave në fuqi ose të cilat hyjnë në fuqi në datën e raportimit. Tatimi aktual i pagueshëm përfshin gjithashtu çdo detyrim tatimor që lind nga deklarimi i dividendëve.

Të drejtat dhe detyrimet tatimore aktuale kompensohen vetëm nëse plotësohen disa kriteret.

##### **(ii) Tatimi i shtyrë**

Tatimi i shtyrë përlllogaritet mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës së mbartur të të drejtave dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore.

Aktivitetet tatimore të shtyra njihet për humbjet tatimore të papërdorura, kreditimet tatimore dhe diferencat tatimore të zbritshme deri në atë nivel ku është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i vlefshëm kundrejt të cilit mund të përdoren këto aktive tatimore të shtyra. Aktivitetet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në atë nivel që nuk ka më mundësi që të realizohet fitimi nga tatimet bazuar në planin e biznesit. Aktivitetet tatimore të shtyra rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në atë masë që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i vlefshëm kundrejt të cilit të përdoren këto aktive tatimore të shtyra.

Aktivitetet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën që është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme të disponohen për t'u përdorur.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato anulohen, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare.

Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që ndjekin mënyrën sipas të cilës Banka parashikon, në fund të periudhës së raportimit, të rikuperojë ose likuidojë vlerën e mbartur të të drejtave dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë matet me normat e taksave të cilat janë parashikuar të zbatohen mbi diferencat e përkohshme në momentin e kthimit të tyre, duke përdorur normat e taksave në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Të drejtat dhe detyrimet tatimore e shtyra kompensohen vetëm nëse plotësohen disa kriteret.

### 3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

#### (g) Aktivet dhe detyrimet financiare

##### (i) Njohja

Banka fillimisht njihet huatë dhe paradhëniet, depozitat dhe huamarrjet në datën kur ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit kur banka angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivitetit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit. Aktivi ose detyrimi financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus, për një instrument që nuk matet me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave, kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes ose emetimit të tij.

##### (ii) Klasifikimi

#### **Aktivitetet financiare**

Banka klasifikon aktivet e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Hua dhe të arkëtueshme, të matura me koston e amortizimit;
- Letra me vlerë të investimit, të matura me koston e amortizimit; ose
- Letra me vlerë të vendosjes, të matura me vlerën e drejtë.

Shih shënimet 3 (g), (h) dhe (i).

#### **Detyrimet financiare**

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare, si detyrime financiare të tjera, të matura më pas me koston e tyre të amortizuara.

Shih shënimet 3 (n) dhe (o).

##### (iii) Çregjistrimi

#### **Aktivitetet financiare**

Banka nuk e njihet më një aktiv financiar nëse të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga aktivi janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar, ose ku banka nuk transferon dhe nuk mban asnjë nga rreziqet apo përfitimet e pronësisë si dhe nuk ruan kontrollin ndaj aktivitetit financiar.

Për mos-njohjen e një aktiviteti financiar, diferenca midis vlerës së mbartur të aktivitetit (ose vlerës së mbartur që i caktohet pjesës së aktivitetit të çregjistruar/fshire) dhe shumës së (i) pagesës së arkëtuar (përfshirë çdo aktiv të ri të përfituar duke i zbritur detyrimin e ri të presupozuar) dhe (ii) fitimit ose shpenzimeve të akumuluar që njihen tek të ardhura të tjera përmbledhëse njihet në pasqyrën e të ardhurave. Çdo interes në aktivitetet financiare të transferuara të cilat plotësojnë kriteret për mos-njohjen e tyre, që krijohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Banka kryen transaksione nëpërmjet të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e aktiveve të transferuara, apo ndonjë pjesë të tyre. Në këto raste, aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Si shembull të këtyre transaksioneve përmendim huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e marrëveshjeve të riblerjes.

### 3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

#### (g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Çregjistrimi (vazhdim)

##### **Detyrimet financiare**

Banka çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë shfuqizuar, anuluar ose kur u skadon afati.

(iv) Kompensimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Banka gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitet dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit, ose për fitime apo humbje të cilat rezultojnë nga realizimi i transaksioneve të ngjashme në aktivitetin tregtar të Bankës.

(v) Matja me koston e amortizuar

Kosto e amortizuar e aktivitet ose detyrimit financiar përbën shumën me të cilën aktivi dhe detyrimi financiar matet në fazën e njohjes fillestare, minus kthimin e principalit, plus ose minus vlerën e amortizimit të akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për të gjitha ndryshimet midis shumës fillestare që është njohur dhe shumës së maturuar, duke zbritur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(vi) Matja me vlerën e drejtë

Vlera e drejtë është çmimi që përfitohet nga shitja e një aktivi ose që paguhet për të transferuar një detyrim, nëpërmjet një transaksioni të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në kapital, ose në mungesë të tij në tregun më të mirë në të cilin Banka ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mospagimit të tij.

Sipas rastit, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me një periodicitet dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar në mënyrë të vazhdueshme të dhëna dhe informacion për çmimin.

Nëse në tregun aktiv nuk ka një çmim të kuotuar, atëherë Banka përdor teknikat e vlerësimit të cilat maksimizojnë përdorimin e të dhënave përkatëse të njohura dhe do të minimizojë përdorimin e të dhënave të panjohura. Teknikat e vlerësimit që janë zgjedhur përfshijnë të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të marrin në konsideratë për vlerësimin e çmimit të një transaksioni.

Treguesi më i mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e pagesës së kryer ose të arkëtuar. Nëse Banka vendos se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk përcaktohet nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim të ngjashëm dhe as nuk bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor të dhëna njohura në tregje, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, dhe rregullohet për diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Në vijim, diferenca njihet në fitim humbje siç duhet gjatë kohëzgjatjes së instrumentit, por jo më vonë se periudha kur vlerësimi është plotësisht i mbështetur me të dhëna të njohura në treg ose kur mbyllet transaksioni.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më e vogël se shuma që paguhet në momentin e kërkesës, e cila zbritet nga data e parë kur do të kërkohej pagesa e depozitës.

Banka njeh transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës së raportimit gjatë të cilës ka ndodhur ndryshimi.

### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ekzistojnë fakte objektive që aktivet financiare të cilat nuk janë mbajtur me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave janë të zhvlerësuar. Aktivet financiare ose një grup i aktiveve financiare zhvlerësohet më vete kur faktet objektive ose kriteret e gjykimit tregojnë që një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit (aktiveve), dhe që kjo ngjarje humbjeje ka një impakt në flukset e ardhshme të parasë nga ky mjet që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme.

Faktet objektive që aktivet janë zhvlerësuar mund të përfshijnë vështirësi të konsiderueshme financiare të huamarrësit ose emetuesit, mospërmbushje e detyrimeve ose shkelje e detyrimeve nga huamarrësi në lidhje me pagesat e interesit dhe të principalit, ristrukturimin e një huaje ose paradhënie nga Banka për shkak të vështirësive financiare të klientit dhe me kushte që Banka nuk mund të shqyrtojë ndryshe, tregues që një huamarrës ose emetues do të falimentojë, zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të njohura në nivel kombëtar ose lokal në lidhje me një grup aktivesh si ndryshimet jo të favorshme në statusin e pagesës së huamarrësve dhe ose emetuesve në grup, ose kushtet ekonomike të cilat lidhen me mospërmbushjen e detyrimeve në grup, apo një rënie e matshme të parashikimit të rrjedhës së parave që pritet nga një grup i aktiveve financiare që nga momenti i njohjes fillestare të këtyre aktiveve.

Banka merr në konsideratë treguesit për zhvlerësimin e huave dhe paradhënive dhe të investimeve në letra me vlerë të vendosjes në nivelin e një aktivi të vetëm dhe kolektivisht. Të gjitha aktivet financiare të rëndësishme, huatë, paradhëniet dhe investimet në letra me vlerë të vendosjes, vlerësohen veçmas për zhvlerësime specifike. Aktivet financiare të cilat nuk rezultojnë të zhvlerësuar në veçanti, vlerësohen të gjitha së bashku për ndonjë zhvlerësim që mund t'i ketë ndodhur, duke grupuar së bashku aktivet financiare huatë dhe paradhëniet të cilat paraqesin karakteristika të ngjashme të riskut.

Për vlerësimin e zhvlerësimit kolektiv, Grupi përdor modelimin statistikor të tendencave historike mbi mundësinë e mospagimit, kohën e rikuperimit dhe vlerën e humbjeve, dhe bën një rregullim nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kredisë lejojnë që këto humbje të jenë më të mëdha ose më të vogla se tendencat historike. Normat e mospagesës, normat e humbjeve dhe koha e parashikuar për rikuperimin krahasohen rregullisht me rezultatet aktuale për të siguruar përshtatshmërinë e tyre.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të cilat janë matur me kosto të amortizuar llogariten në bazë të diferencës së shumës së mbartur të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të fluksit të përlllogaritur të mjeteve monetare të skontuar me normën fillestare efektive të interesit të aktiveve. Humbjet njihen tek pasqyra e të ardhurave dhe paraqiten në llogarinë e fondit të huave dhe paradhënive. Kur një ngjarje e mëvonshme influencon në zvogëlimin e shumës së humbjes nga zhvlerësimi i aktivitetit, humbja kthehet tek pasqyra e të ardhurave. Fluksi i parashikuar i mjeteve monetare nga huatë dhe paradhëniet paraqiten me vlerën e skontuar të kolateralit. Të ardhurat nga kolaterali vlerësohen pas zbritjeve nga vlera e tregut dhe përcaktimit të planit kohor të rikuperimit, në varësi të llojit të kolateralit.

Aty ku është e mundur Banka bën ristrukturimin/rinegociimin e huave sesa marrjen në zotërim të kolateralit. Kjo përfshin zgjatjen e afatit të pagesave për kthimin e huasë dhe marrëveshjen për kushte të reja kredie. Nëse kushtet dhe afatet e një aktivi financiar ri-negociohen ose modifikohen ose një aktiv financiar ekzistues zëvendësohet me një aktiv të ri për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë vlerësohet për zhvlerësim më vete. Të gjithë klientët me një linjë të strukturuar kredie janë subjekt i testimit individual të zhvlerësimit dhe mbeten të tillë për një periudhë të paktën dy vjeçare nga ristrukturimi, pavarësisht nga pagesat e kryera në bazë të kushteve të reja të përcaktuara për pagesat. Drejtimi në mënyrë të vazhdueshme rishikon kreditë e ringociuara për të garantuar përmbushjen e të gjitha kriterëve dhe kryerjen e pagesave në të ardhmen.



### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve (vazhdim)

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim humbje dhe pasqyrohen në një llogari për fondin e zhvlerësimit të huave dhe paradhënieve si dhe të investimeve në letra me vlerë të vendosjes, nëse ka. Nëse njohja e një ngjarje që ka ndodhur pas zhvlerësimit zvogëlon humbjen nga zhvlerësimi, zvogëlimi i humbjes nga zhvlerësimi rimerret përmes pasqyrës së të ardhurave. Në rastin e investimeve në letra me vlerë të vendosjes, një rënie e rëndësishme ose e zgjatur në kohë e vlerës së tyre të drejtë nën kosto merret në konsideratë për zhvlerësimin e aktivit. Humbja nga zhvlerësimi në letrat me vlerë të vendosjes njihen duke i riklasifikuar humbjet e mëparshëm të njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse në fitim/humbje. Humbja e akumuluar që riklasifikohen nga të ardhurat e tjera përmbledhëse në fitim/humbje është diferenca midis çmimit të blerjes, neto nga çdo pagesë principali dhe amortizimi, dhe vlerës aktuale të drejtë, minus çdo humbje nga zhvlerësimi të njohur më parë në fitim/humbje.

Ndryshimet e provizioneve për zhvlerësim të cilat i atribuohen zbatimit të metodës së interesit efektiv pasqyrohen si një element përbërës i të ardhurave nga interesi.

Nëse, në një periudhë të mëvonshme, rritet vlera e drejtë e investimit në letra me vlerë të vendosjes të zhvlerësuar dhe rritja lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ka ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi, atëherë humbja nga zhvlerësimi kthehet dhe vlera e kthimit njihet në pasqyrën e të ardhurave, përndryshe çdo rritje në vlerën e drejtë njihet në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse. Megjithatë, çdo rikuperim i mëvonshëm i vlerës së drejtë të investimit në letra me vlerë të vendosjes të zhvlerësuar njihet në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse.

#### **(h) Mjete monetare dhe të ngjashme**

Mjete monetare dhe të ngjashme përfshijnë mjetet në arkë, llogaritë me bankat, gjendjet e pakufizuara me bankat qendrore dhe depozitat afatshkurtra shume likuide me maturitet më pak se tre muaj, të cilat janë subjekt i ndryshimeve jo të rëndësishme të vlerës së tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka për përmbushjen e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjete monetare dhe të ngjashme klasifikohen si hua dhe të arkëtueshme dhe mbahen në pasqyrën e pozicionin financiar me koston e amortizuar.

#### **(i) Huatë dhe paradhëniet**

Huatë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qëllim shitjen e tyre të menjëhershme ose në një kohë të afërt. Huatë dhe paradhëniet maten në fillim me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizimit plus kostot e tjera të transaksioneve direkte, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Pas matjes fillestare, ato maten me koston e amortizimit me normën efektive të interesit, duke zbritur vlerën e zhvlerësimit. Amortizimi përfshihet në të ardhurat nga interesi në fitim/humbje. Humbjet që rezultojnë nga zhvlerësimi njihen në fitim/humbje tek humbjet neto nga zhvlerësimi i mjeteve financiare.

#### **(j) Investime në Letra me Vlerë**

Investimet në letra me vlerë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, në rastin e letrave me vlerë jo të tregtueshme, kostot e tjera të transaksioneve direkte, dhe më pas kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre si letra me vlerë të investimit ose letra me vlerë të vendosjes.

(i) Letra me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimit janë aktive financiare jo derivative me të ardhura fikse ose të përcaktueshme dhe me maturitete fikse që Banka ka qëllimin dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim dhe që nuk klasifikohen si të tregtueshme ose letra me vlerë të vendosjes.

Letrat me vlerë të investimit maten me koston e amortizimit nëpërmjet metodës së interesit efektiv duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi. Të gjitha shitjet dhe riklasifikimet e një shumë të konsiderueshme të letrave me vlerë të investimit që nuk janë afër maturimit riklasifikohen si investime në letra me vlerë të vendosjes dhe nuk e lejojnë Bankën t'i klasifikojë ato në investime në letra me vlerë të investimit për vitin ushtrimor aktual dhe dy vitet ushtrimore të ardhshëm.

### 3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

#### (j) Investime në Letra me Vlerë (vazhdim)

##### (ii) Letra me vlerë të vendosjes

Letrat me vlerë të vendosjes janë instrumente jo derivative të cilat nuk përbëjnë një kategori tjetër të aktiveve financiare. Letrat me vlerë të vendosjes përfshijnë letrat me vlerë të borxhit. Letrat me vlerë të borxhit të pakuotuar, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbahen me kosto. Të gjitha letrat me vlerë të vendosjes mbahen me vlerën e drejtë pas njohjes fillestare. Te ardhurat nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave nëpërmjet metodës së interesit efektiv.

Fitimet ose humbjet nga këmbimet valutore të investimeve në letra me vlerë të vendosjes njihen në fitim/humbje. Humbjet nga zhvlerësimi njihen tek pasqyra e të ardhurave. Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen tek pasqyra e të ardhurave të tjera përmbledhëse dhe paraqiten në rezervën e vlerës së drejtë të kapitalit. Nëse investimi shitet, gjendja në kapital, më parë e njohur në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse, riklasifikohet në fitim humbje.

Një aktiv financiar jo derivative mund të riklasifikohet nga kategoria e letrave me vlerë të vendosjes në kategorinë e huave dhe të arkëtueshme nëse do të plotësojë karakteristikat e huave dhe të arkëtueshme dhe nëse Banka ka si qëllim dhe mundësi ta mbajë aktivin financiar për një periudhë kohe të parashikueshme në të ardhme ose deri në maturim.

#### (k) Ndërtesat dhe pajisjet

##### (i) Njohja dhe matja

Ndërtesat dhe pajisjet paraqiten me koston e tyre neto pasi iu është zbritur zhvlerësimi i akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë të gjitha shpenzimet të cilat mund t'i atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë blerjes së mjetit. Ndertesat maten me vlerën e rivlerësuar, e cila është vlera e drejtë në datën e rivlerësimit minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi (shih shënimin 12). Nëse pjesë të një aktivi kanë jetëgjatësi përdorimi të ndryshme, atëherë këto pjesë kontabilizohen si elementë të veçanta (përbërësit kryesor) të ndërtesave dhe pajisjeve. Të gjitha fitimet ose humbjet nga shitja e një ndërtese dhe pajisje (të llogaritur si diferenca midis të ardhurave neto nga shitje dhe vlera e mbartur e objektit) njihet me të ardhurat e tjera në fitim humbje.

##### (ii) Kostot vijuese

Kostot vijuese kapitalizohen nëse është e mundur që të sigurohen përfitime të ardhshme ekonomike për Bankën. Kostot e riparimit dhe të mirëmbajtjes njihen si shpenzime në pasqyrën e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse.

##### (iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën lineare përgjatë gjithë kohëzgjatjes së jetës së përdorimit të çdo pjese të ndërtesës dhe pajisjes. Trualli dhe Veprat e Artit nuk zhvlerësohen.

Jetëgjatësitë e parashikuara të përdorimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë të paraqitura si më poshtë:

	<b>2017</b>	<b>2016</b>
• Ndërtesat	33 vjet	20 vjet
• Kompjuterët dhe pajisje të tjera kompjuterike	4 deri në 8 vjet	4 deri në 8 vjet
• Mobiliat, orenditë dhe pajisjet	3 deri në 10 vjet	3 deri në 10 vjet
• Aktive të tjera jo elektrike	5 vjet	i. vjet

### 3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

#### (l) Aktive Afatgjata Jo-materiale

Programet kompjuterike, licencat dhe markat tregtare përbëjnë aktivet afatgjata jo-materiale dhe paraqiten me koston neto nga amortizimi i akumuluar. Shpenzimet e mëtejshme në aktivet afatgjata jo-materiale kapitalizohen vetëm nëse këto shpenzime rrisin të mirat e ardhshme ekonomike të këtij mjeti specifik. Çdo lloj kostoje tjetër shpenzohet në periudhën në të cilën kryhet. Amortizimi pasqyrohet të pasqyra e të ardhurave duke përdorur metodën lineare të amortizimit për të gjithë jetëgjatësinë e aktiveve afatgjata jo-materiale, duke filluar nga data e përdorimit të tyre. Jetëgjatësia e parashikuar e përdorimit për periudhën aktuale dhe krahasuese vijon si më poshtë:

	2017	2016
• Programe kompjuterike	5 vjet	5 vjet
• Licencat dhe markat tregtare	10 vjet	10 vjet

#### (m) Aktivet materiale afatgjata të investuara

Aktivitet materiale afatgjata të investuara fillimisht maten me metodën e koston dhe më pas me vlerën e drejtë, ku çdo ndryshim i vlerës do të njihet në fitim ose humbje brenda të ardhurave të tjera. Kur përdorimi i një aktivi ndryshon në mënyrë të tillë që të riklasifikohet si ndërtesa dhe pajisje, vlera e drejtë e saj në datën e riklasifikimit do të konsiderohet kosto sipas për kontabilitetit e ardhshëm.

#### (n) Inventari

Inventari përfshin aktivet e rimarra në pronësi përmes ekzekutimit të garancisë për huatë me probleme dhe paradhëniet e klientëve të cilët nuk sigurojnë të ardhura, nuk përdoren nga Banka dhe janë planifikuar për shitje brenda një kohe të shkurtër të arsyeshme, pa ristrukturim të konsiderueshëm. Aktivitet e rimarra në pronësi paraqiten me vlerën e tyre më të ulët të realizueshme dhe fshirja e tyre njihet në pasqyrën e të ardhurave.

#### (o) Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Në çdo datë raportimi, Banka rishikon vlerën e mbartur të aktiveve jo financiare, të ndryshme nga inventari dhe të drejtave tatimore të shtyre, për të përcaktuar nëse ka tregues të zhvlerësimit. Në rast se rezultojnë tregues të tillë, atëherë përlogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e një aktivi tejkalon shumën e rikuperimit. Vlera e rikuperueshme e një aktivi është më e madhja prej vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston për t'u shitur. Për vlerësimin e vlerës në përdorim, fluksi i të ardhurave të parashikuara skontohehet në vlerë aktuale me normën e zbritjes para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut me vlerën kohe të parasë dhe risqet specifike të aktivitet. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim humbje. Humbjet nga zhvlerësimi rimerren vetëm kur shuma e mbartur e aktivitet nuk e tejkalon shumën e mbartur që do të ishte përcaktuar, pa zhvlerësimin ose amortizimin, nëse nuk do të njihet asnjë humbje nga zhvlerësimi.

#### (p) Depozitat

Depozitat përbëjnë burimet e financimit të Bankës.

Depozitat fillimisht maten me vlerën e drejtë plus koston direkte të transaksionit, dhe me pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëkohësisht nënshkruan një marrëveshje për të riblerë aktivin (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë në të ardhmen ("repo" ose "stock lending"), marrëveshja kontabilizohet si depozitë, dhe aktivi në fjalë vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

### 3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

#### (q) Provizionet

Një provizion mund të njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën, Banka disponon një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet me besueshmëri dhe që gjithashtu është e mundur që të kërkojë dalje të përfitimeve ekonomike për të mbyllur detyrimin. Provizionet përcaktohen duke përdorur si normë skontimi për flukset e pritshme të parasë në të ardhmen, një norme para taksës e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe aty ku është e përshtatshme, edhe specifikat e riskut për detyrimin.

#### (r) Taksat për bankë

Një provigjon për taksat për bankë njihet kur plotësohet kushti që shkakton pagesën e taksës. Nëse detyrimi i nënshtrohet një minimumi të aktivitetit në mënyrë që ngjarja obliguese të arrijë një aktivitet minimal, atëherë një provigjon njihet kur arrihet pragu minimal i aktivitetit.

#### (s) Përfitimet e punonjësve

##### (i) Planet e përcaktuara të kontributeve

Banka operon vetëm me kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që sigurojnë përfitime pensioni për personelin në momentin e daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjës për të siguruar minimumin e nivelit të pensionit sipas ligjit për pensionet në Shqipëri në bazë të një plani të përcaktuar kontributi për pensionin. Kontributet e Bankës ndaj përfitimeve të planit të pensionit pasqyrohen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

##### (ii) Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtër të punonjësve llogariten mbi një bazë të paskontueshme dhe njihen si shpenzime kur shërbimi përkatës është siguruar. Një provizion njihet për vlerën e pritur për t'u paguar në bazë të një plani shpërblimi afat-shkurtër në mjete monetare ose plani për ndarjen e fitimit, nëse Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i një shërbimi të kryer në të kaluarën nga punonjësi dhe ky detyrim mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

#### (t) Standarde dhe interpretime të reja ende jo në fuqi

Një numër standardesh të reja, ndryshime të standardeve dhe interpretimeve janë në fuqi për periudhat vjetore duke filluar pas datës 1 Janar 2017. Megjithatë, Banka për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare nuk ka zbatuar paraprakisht standardet e reja dhe të amenduara që vijnë më poshtë.

#### **SNRF 9 Instrumentet financiare**

Në korrik 2014, BSNK lëshoi versionin përfundimtar të SNRF 9 *Instrumentat Financiarë*. SNRF 9 hyn në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në dhe pas datës 1 Janar 2018, duke lejuar dhe zbatimin e hershëm. Ky standard zëvendëson SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja, që rregullonte klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare deri më 31 Dhjetor 2017.

Bazuar në vlerësimet e ndërmarra deri më sot, në total rregullimi i parashikuar i adoptimit të SNRF 9 në bilancin e hapjes të kapitalit të Bankës më 1 janar 2018 është afërsisht 949 milionë lekë dhe lidhet vetëm me kërkesat për zhvlerësim (shih shënimin (ii)) që perfaqesojnë:

- një zvogëlim prej rreth 675 milionë Lek lidhur me huatë dhe paradhëniet (hua me dhe pa probleme );
- një zvogëlim prej rreth 265 milionë Lek lidhur me letrat me vlerë të borxhit pa probleme; dhe
- një zvogëlim prej rreth 8.6 milionë Lek lidhur me zërat jashtë bilancit.

Banka nuk ka bërë ndonjë vlerësim në lidhje me ndikimin në tatimet e shtyra.

SNRF 9 ndahet në tri pjesë: klasifikimi dhe matja e instrumenteve financiare, zhvlerësimi dhe kontabiliteti mbrojtës.

### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **(t) Standarde dhe interpretime të reja ende jo në fuqi (vazhdim)**

##### **SNRF 9 Instrumentet financiare(vazhdim)**

###### **(i) Klasifikimi – Aktivet financiare**

SNRF 9 përdor një mënyrë të re klasifikimi dhe matjeje për aktivet financiare që pasqyrojnë modelin e biznesit në të cilin menaxhohen aktivet dhe karakteristikat flukseve të mjeteve monetare të tyre. SNRF 9 përfshin tre kategori kryesore klasifikimi për aktivet financiare: matjen me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj) dhe vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPFH). Ky klasifikim eliminon kategoritë ekzistuese të SNK 39: letra me vlerë të vendosjes, huatë, llogaritë e arkëtueshme dhe letra me vlerë të investimit.

Aktivët financiarë mund të regjistrohen në dy kategoritë e para dhe për këtë arsye të maten me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse vetëm nëse provohet se ato krijojnë flukse monetare të llojit "vetëm pagesa principali dhe interesi" (testi VPPI).

Investimet në instrumente kapitali gjithmonë regjistrohet në kategorinë e tretë dhe matet me vlerën e drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes, përveç rasteve kur njësisia ekonomike zgjedh (në mënyrë të pakthyeshme, në njohjen fillestare) të paraqesë ndryshimet në vlerën e aksioneve që nuk mbahen për tregtim në rezervën e kapitalit neto që nuk mundet asnjëherë të kalojnë në fitim dhe humbje, edhe në rastet e fshirjes së instrumentit (Aktivet financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse pa rimarrje).

Nuk kërkon ndryshime të rëndësishme lidhur me klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare. Ndryshimi i vetëm është trajtimi i rrezikut të kredisë: për detyrimet financiare të njohura me vlerën e drejtë (opsionet me vlerë të drejtë), standardi thekson që ndryshimet në vlerën e drejtë të detyrimeve që i atribuohen ndryshimeve në rrezikun e kredisë duhet të njihen në kapitalin neto, përveç rasteve që ky trajtim krijon një mospërputhje kontabël në fitimin e periudhës, ndërsa shuma e mbetur e ndryshimeve në vlerën e drejtë të detyrimeve duhet të njihet në pasqyrën e të ardhurave (fitim dhe humbje).

###### **Vlerësimi i modelit të biznesit**

Banka ka bërë një vlerësim të qëllimit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv financiar mbahet në nivel portfoli. Aktivët financiarë që mbahen për tregtim dhe ato të administruara dhe performanca e të cilave vlerësohet me vlerën e drejtë, do të maten me VDPFH sepse ato nuk mbahen për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale dhe as për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale dhe shitjen e aktiveve financiare.

Vlerësimi i flukseve monetare kontraktuale të cilat përbëhen vetëm nga pagesa e principalit dhe e interesit

Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë të përbëra vetëm nga pagesa e principalit dhe interesit, Banka ka marrë në konsideratë kushtet kontraktuale të instrumentit, i cili përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një term kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale në mënyrë që të mos plotësojë këtë kusht.

###### **Vlerësimi i ndikimit**

Standardi do të ndikojë në klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare të mbajtura më 1 janar 2018 si vijon:

-Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët që klasifikohen si kredi dhe të arkëtueshme dhe maten me koston e amortizuar sipas SNK 39 do të maten me koston e amortizuar sipas SNRF 9.

-Letrat me vlerë të investimit të mbajtura deri në maturim të cilat maten me koston e amortizuar sipas SNK 39 do të maten me koston e amortizuar sipas SNRF 9.

-Letrat me vlerë të investimit të borxhit që klasifikohen si të vlefshme për shitje sipas SNK 39 do të maten sipas SNRF 9 me koston e amortizuar, VDATGj ose VDPFH, në varësi të rrethanave të përcaktuara.

### 3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

#### (t) Standarde dhe interpretime të reja ende jo në fuqi (vazhdim)

##### SNRF 9 Instrumentet financiare (vazhdim)

###### (iii) Zhvlerësimi

Në lidhje me zhvlerësimin, aktivet e matura me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (përveç kapitalit) duhet t'i nënshtrohen modelit të ri bazuar në humbjen e pritshme, duke zëvendësuar modelin aktual të humbjes, për të njohur humbjet më herët.

SNRF 9 zëvendëson modelin e 'humbjeve të ndodhura' në SNK 39 me një model të parashikuar të 'humbjes së pritshme të kredisë', ku kërkohet një gjykim i konsiderueshëm mbi atë se si ndryshimet në faktorët ekonomikë ndikojnë tek HPK-të, të cilat do të përcaktohen në bazë të probabilitetit të ponderuar. Vendosja e rregulloreve të reja për zhvlerësim do të thotë:

-shpërndarjen e aktiveve ekzistuese në faza të ndryshme të rrezikut të kredisë (ndarja në faza), me korrigjimet korresponduese bazuar në humbjet e pritshme 12-mujore (faza 1) ose gjatë gjithë jetëgjatësisë (faza 2) në rast të rritjes së konsiderueshme të rrezikut të kredisë e përcaktuar nga krahasimi i probabilitetit të mospagimit në njohjen fillestare dhe në datën e raportimit;

-shpërndarjen e aktiveve me probleme në Fazën 3, rregulluar sipas humbjeve të pritura gjatë jetëgjatësisë së aktivitetit;

-përfshirjen e informacionit të parashikuar në llogaritjen e Humbjeve të Pritshme të Kredisë (HPK) të lidhura edhe me ndryshimet në skenarin makroekonomik.

Së fundmi, në lidhje me kontabilitetin mbrojtës, modeli i ri - i cili nuk zbatohet për mbulimin makro - synon të harmonizojë njohjen e kontabilitetit me menaxhimin e rrezikut dhe të përforcojë zbulimin e aktiviteteve të administrimit të rrezikut të njësisë ekonomike që përgatit pasqyrat financiare.

Qasja ndaj zbatimit të parë të SNRF 9

Në gjysmën e dytë të vitit 2017, Banka nisi një "veprim paralel" të zbatimit të standardit të ri që përfshinte një qasje modulare, gjithnjë e më të plotë, sipas disponueshmërisë së informacionit dhe mbështetjes së nevojshme teknologjike. Qëllimi i veprimit paralel është të kontrollojë zbatimin e saktë të teknologjisë që mbështet menaxhimin e ndryshimeve të paraqitura nga SNRF 9 dhe një vlerësim më të saktë të ndikimeve të MTL.

Në tremujorin e parë të vitit 2017, Banka Qendrore Evropiane (BQE) kreu një "Rishqyrtim Tematik", përfshirë edhe në Grupin Intesa Sanpaolo, të përqendruar në zbatimin e SNRF 9. Intesa Sanpaolo ka marrë konkluzionet përfundimtare të BQE ku shprehet se në përgjithësi, zbatimi i standardit të ri është në përputhje me pritjet e Autoritetit. Konkluzionet gjithashtu përmbajnë disa sugjerime dhe rekomandime ("gjetje") të përfshira tashmë në strategjinë e zbatimit për standardin e ri. Gjetjet lidhen kryesisht me përkufizimin e rregulloreve të politikave të brendshme që, si zakonisht, është përfunduar në fund të projektit. Shkurtimisht, gjetjet i referohen nevojës për të integruar procedurat dhe për të përcaktuar në detaje rregullat dhe rregulloret e brendshme (veçanërisht ato që lidhen me rishikimin dhe përditësimin e qasjeve për të përcaktuar SICR dhe llogaritjen e humbjes së pritshme) që janë në fuqi me futjen e SNRF 9, dhe theksojnë rëndësinë e aprovimit të brendshëm dhe të testimit historik të të dhënave. Në këtë kuadër, rregulloret e brendshme - veçanërisht Politikën e Kontabilitetit të Grupit, Politika e re e Zhvlerësimit dhe kuadri i modelit të biznesit të Grupit - janë përditësuar dhe miratuar nga nivelet kompetente të qeverisjes.

Matja e HPK-ve

HPK-të janë një vlerësim i probabilitetit i humbjeve të kredive të ponderuar dhe maten si më poshtë:

- aktivet financiare që nuk janë të zhvlerësuar në datën e raportimit: vlera aktuale e të gjitha mjeteve monetare psh. dallimi midis flukseve të mjeteve monetare për shkak të njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe flukset e mjeteve monetare që Banka pret të marrë;

- aktivet financiare që janë të zhvlerësuar në datën e raportimit: diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuar.

### **3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

#### **(t) Standarde dhe interpretime të reja ende jo në fuqi (vazhdim)**

##### **SNRF 9 Instrumentet financiare (vazhdim)**

###### **(ii) Zhvlerësimi (vazhdim)**

Të dhënat në matjen e HPK-ve

Të dhënat kryesore në matjen e HPK-ve janë: probabiliteti i dështimit (PD); humbja e mundshme e dështimit (LGD); dhe ekspozimi në dështim (EAD). Këto parametra rrjedhin nga modelet statistikore të zhvilluara brenda vendit dhe të dhëna të tjera historike që përdorin modelet rregullatore. Ato do të rregullohen për të pasqyruar informacionin e ardhshëm.

Ndikimi aktual i adoptimit të SNRF 9 më 1 janar 2018 mund të ndryshojë për shkak se:

- SNRF 9 kërkon që Banka të rishikojë proceset e kontabilitetit dhe kontrollet e brendshme dhe këto ndryshime nuk janë ende të plota;
- megjithëse u veprua paralelisht në gjysmën e dytë të vitit 2017, sistemet e reja dhe kontrollet e ndërlidhura në vend nuk kanë funksionuar për një periudhë më të gjatë;
- Banka nuk ka përfunduar testimin dhe vlerësimin e kontrolleve mbi sistemet e reja të IT-së dhe ndryshimet në kuadrin e saj të qeverisjes;
- politikat e reja kontabël, supozimet, gjykimet dhe teknikat e vlerësimit të përdorura mund të ndryshojnë derisa Banka të përfundojë pasqyrat e saj të para financiare që përfshijnë datën e aplikimit fillestar.

##### **SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Klientët**

SNRF 15 hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më dhe pas datës 1 janar 2018, duke lejuar dhe zbatimin më të hershëm. Standardi i ri zëvendëson udhëzimet ekzistuese për njohjen e të ardhurave sipas SNRF, duke përfshirë SNK 18 Të ardhurat, SNK 11 Kontratat e Ndërtimit dhe KIRFN 13 Programet e Besnikërisë së Klientit. Shoqëritë do të zbatojnë një model me pesë hapa për të përcaktuar kur duhet njohur e ardhura dhe në çfarë shume. Modeli i ri saktëson që e ardhura duhet të njihet kur (ose ndërkohë që) një njësi ekonomike transferon kontrollin mbi mallrat ose shërbimet tek një klient për shumën të cilën njësi ekonomike pret të ketë të drejtën të arkëtojë. Në varësi të përmbushjes së disa kriterëve, e ardhura njihet:

- përgjatë periudhës, në një mënyrë që pasqyron ecurinë e njësisë ekonomike; ose
- në një moment kohor, kur kontrolli mbi mallrat ose shërbimet i transferohet klientit.

SNRF 15 gjithashtu vendos parimet që një njësi ekonomike duhet të zbatojë për dhënien e shënimeve shpjeguese cilësore dhe sasiore që japin informacion të dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare mbi natyrën, shumën, kohën dhe pasigurinë në lidhje me të ardhurat si dhe mbi flukset monetare nga kontratat me klientët.

Megjithëse ende nuk ka përfunduar vlerësimin e tij fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 15 mbi pasqyrat financiare të Bankës, drejtimi nuk pret që standardi i ri, në momentin e zbatimit fillestar të tij, të ketë ndonjë ndikim material mbi pasqyrat financiare të Bankës në momentin e zbatimit të tij. Koha dhe matja e të ardhurave të Bankës nuk pritet të ndryshojnë me SNRF 15 për shkak të natyrës së veprimtarive të Bankës dhe llojit të të ardhurave që realizon. Megjithatë, ky vlerësim mund të ndryshojë pasi Banka të finalizojë proceset dhe politikat kontabël në përputhje me kërkesat e SNRF 15.

### 3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

#### (t) Standarde dhe interpretime të reja ende jo në fuqi (vazhdim)

##### SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 zëvendëson udhëzimet ekzistuese për qiratë, duke përfshirë SNK 17 *Qiratë*, KIRFN 4 *Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira*, KIS-15 *Qiratë Operative - Stimujt dhe KIS-27 Vlerësimi i Përmbajtjes së Transaksioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të një Qiraje*. Standardi i ri sjell një model të vetëm kontabël të paraqitjes në bilanc të qirave nga qiramarrësit. Një qiramarrës njuh një aktiv për të drejtën e përdorimit që përfaqëson të drejtën e tij të përdorimit të aktivitet bazë dhe një detyrim qiraje që përfaqëson detyrimin e tij për të bërë pagesa qiraje. Ka përjashtime nga njohja për qiratë afat-shkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët. Kontabiliteti nga qiradhënësi mbetet i ngjashëm me standardin aktual – pra, qiradhënësit do të vazhdojnë të klasifikojnë qiratë si financiare ose operative. Standardi hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 duke lejuar edhe zbatim më të hershëm për njësitë ekonomike që zbatojnë SNRF 15 në ose para datës së zbatimit fillestar të SNRF 16.

Banka ka kryer një vlerësim fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 16 mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, por nuk ka kryer ende një vlerësim të detajuar. Ndikimi aktual i zbatimit të SNRF 16 mbi pasqyrat financiare të konsoliduara në periudhën e zbatimit fillestar do të varet nga kushtet e ardhshme ekonomike, duke përfshirë normën e huamarrjes së Bankës më 1 janar 2019, përbërjen e portofolit të qirave së Bankës në atë datë, vlerësimin më të fundit të Bankës nëse do të ushtrojë ndonjë nga mundësitë e rinovimit të qirave si dhe shkallën në të cilën Banka do të zgjedhë të përdorë lehtësitë praktike dhe përjashtimet nga njohja.

Deri më tani, ndikimi më i rëndësishëm i identifikuar është njohja e aktiveve dhe detyrimeve të reja të qirave operative të automjeteve. Më 31 dhjetor 2017, pagesat e paskontuara minimale të ardhshme të qirasë për qiratë operationale të pa-anullueshme arrijnë në 339 milion Lek.

Për pagesat e ardhshme të paskontuara të qirasë nën qiratë operative të pa-anullueshme më 31 dhjetor 2017, shih shënimin 32. Për më tepër, natyra e shpenzimeve që lidhen me këto qera do të ndryshojë pasi SNRF 16 zëvendëson shpenzimet e njëtrajtëshme të qirasë me shpenzimin e amortizimit të së drejtës së përdorimit të aktiveve me qira dhe shpenzimin e interesit mbi detyrimet e qirasë.

##### Standarde dhe interpretime të tjera

Ndryshimet e mëposhtme në standarde dhe interpretime nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës paraqiten si më poshtë:

- *Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2014-2016 - Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28;*
- *Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione (Ndryshime në SNRF 2).;*
- *Transferimi i aktiveve materiale afatgjata të investuara (Ndryshime në SNK 40);*
- *Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarrjes së Përbashkët përkatëse (Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28);*
- *KIRFN 22 Transaksionet dhe Paradhëniet në Monedhë të Huaj;*
- *KIRFN 23 Pasiguritë mbi Trajtimet e Tatimit mbi Fitimin;;*
- *Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNRF 9);*
- *Interesat Afatgjatë në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28);*
- *Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2015-2017 - Ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23);*
- *Ndryshimet, Shkurtimeve ose Shlyerjet e Planit të Pensioneve (Ndryshimet në SNK 19);;*



#### 4. Administrimi i Riskut Financiar

Si pasojë e përdorimit të instrumenteve financiare, Banka ekspozohet ndaj risqeve të mëposhtëm:

- a. risku i kredisë
- b. risku i likuiditetit
- c. risku i tregut
- d. risku operacional

Ky shënim jep informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit prej llojeve të risqeve, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e riskut si dhe administrimin e kapitalit të Bankës.

##### **Kuadri i Administrimit të Riskut**

Këshilli Drejtues i Bankës ka përgjegjësinë kryesore për krijimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të administrimit të riskut të Bankës. Këshilli Drejtues ka krijuar Komitetet e Qeverisjes së Bankës (Komitetin e Drejtuesve Ekzekutiv, Komitetin e Kredisë, Komitetin e Riskut Financiar, Komitetin e Riskut Operacional, Komitetin e Administrimit të Riskut të Kredisë, Komitetin e Kredive me Probleme dhe komitete të tjera) të cilat kanë autoritetin për vendimmarrje sipas fushave të tyre të caktuara.

Divizioni i Administrimit të Riskut është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të riskut të Bankës në këto fusha. Të gjitha komitetet e Bankës kanë anëtarë ekzekutiv dhe jo ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Këshilli Drejtues për aktivitetet e tyre. Politikat e administrimit të riskut të Bankës janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar riskun me të cilin përballet Banka, për të vendosur limitet dhe kontrollin e duhur si dhe për të monitoruar risqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e administrimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut si dhe produktet dhe shërbimet e ofruara.

##### **(a) Risku i kredisë**

Në aktivitetin normal të biznesit të saj, Banka është e ekspozuar ndaj riskut të kredisë në huadhëniet dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe institucioneve financiare, investimet në letra me vlerë dhe zëra të tjerë jashtë bilancit. Risku i kredisë është risku i një humbjeje financiare të Bankës nëse një klient ose palë e ngjashme që posedon një instrument financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktore që burojnë nga huadhënia e Bankës ndaj klientëve, letra me vlerë të borxhit, financime me institucione të tjera financiare ose që burojnë nga zëra të tjerë jashtë bilancit. Për arsye raportimi të administrimit të riskut, Banka konsideron dhe konsolidon të gjithë elementet e ekspozimit ndaj riskut të kredisë (si risku individual i mospërmbushjes së detyrimeve, risku i sektorëve të ekonomisë si dhe risku lokal). Banka e administron ekspozimin e saj ndaj riskut të kredisë periodikisht duke monitoruar nga afër limitet e kredisë, portofolin e huave dhe përqendrimin e ekspozimit.

##### **Administrimi i Riskut të Kredisë**

Këshilli Drejtues i Bankës i ka deleguar përgjegjësi për marrjen e vendimeve Komiteteve të Riskut. Njësia për Administrimin e Riskut, i cili raporton tek Drejtori Përgjithshëm Ekonomik ('DPE'), është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe administrimin e riskut të kredisë së Bankës, duke përfshirë detyrat e mëposhtme:

- *Formulimin e politikave të kredisë* duke u konsultuar me njësitë e biznesit, mbulimin e kërkesave për kolateral, vlerësimin e kredisë, përcaktimin e nivelit të riskut dhe raportimin e tij, procedurat e dokumentimit dhe ato ligjore, si dhe përputhshmërinë me kërkesat rregullative dhe statutore.
- *Rishikimin dhe vlerësimin e riskut të kredisë*. Departamenti i Riskut të Kredisë vlerëson të gjitha ekspozimet e kredisë përpara angazhimit me klientë nga Banka. Rinovimet dhe rishikimet e kushteve të kredive janë objekt i të njëjtit proces rishikimi.
- *Kufizimin e përqendrimit të ekspozimit* sipas palëve, vendndodhjes dhe industrisë, (për huadhënie dhe paradhënie) si dhe sipas lëshuesit, kategorisë së klasifikimit të kredisë, likuiditetit të tregut dhe vendit (për investimet në letrat me vlerë).

## 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

### (a) Risku i kredisë (vazhdim)

- *Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e klasifikimit të riskut të Bankës* në mënyrë që të kategorizojë ekspozimet sipas nivelit të riskut të humbjes financiare që përballet si dhe të fokusojë administrimit e risqeve të tjerë shoqërues. Klasifikimi i riskut përdoret për të përcaktuar nevojën e provigjionimit të dëmeve ndaj ekspozimeve specifike të kredisë.

Në përputhje me metodologjinë e Bankës të gjitha ekspozimet janë të klasifikuara si ekspozime pa probleme dhe me probleme (duke përfshirë huatë e vonuara, të ristrukturuara dhe të dyshimta). Banka klasifikon portofolin e ekspozimeve me probleme duke analizuar ato në bazë të një grupi rregullash të harmonizuara me udhëzimet e Grupit Intesa Sanpaolo. Këto rregulla përfshijnë faktet objektive si: shkelja e kontratës (moskryerja e pagesave të interesit dhe principalit); vështirësi të mëdha financiare të huamarrësit; dhe informacione të tjera të rëndësishme financiare për klientin.

- *Rishikimin e përputhshmërisë së njësive të biznesit me limitet e ekspozimit të miratuara duke përfshirë ato për industritë e zgjedhura dhe llojet e produkteve.* Në Komitetin e Aktiveve me Probleme paraqiten çdo muaj analiza të detajuara për cilësinë e kredisë të ekspozimeve të klientëve si dhe propozime për veprimet rregulluese të duhura që duhen ndërmarrë.
- *Ofrimin e konsultave, udhëzimeve dhe aftësive profesionale* ndaj njësive të biznesit për të promovuar në Bankë praktikën më të mirë të administrimit të riskut të kredisë .

### Ekspozimi Maksimal ndaj Riskut të Kredisë

Tabela e mëposhtme tregon ekspozimin aktual maksimal ndaj riskut të kredisë për komponentët e aplikueshëm të bilancit:

	Ekspozimi Maksimal Bruto	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mjete monetare dhe të ngjashme (pa përfshirë arkën)	21,585,207	25,968,849
Hua dhe paradhënie bankave	20,171,066	17,106,968
Aktive financiare-letra me vlerë të vendosjes	9,423,008	7,251,448
Aktive financiare-letra me vlerë të investimit	49,110,119	50,729,433
Hua dhe paradhënie klientëve	46,557,253	42,542,151
Debitorë të ndryshëm	62,045	57,462
<b>Totali i riskut në bilanc</b>	<b>146,908,698</b>	<b>143,656,311</b>
Huadhënie të aprovuara por jo të disbursuara	5,832,819	4,977,785
Letër Kredi	3,025,244	355,827
Garanci të dhëna në favor të klientëve	3,930,155	4,664,841
<b>Totali i angazhimeve në lidhje me kredinë</b>	<b>12,788,218</b>	<b>9,998,453</b>
<b>Totali i Ekspozimit ndaj Riskut të Kredisë</b>	<b>159,696,916</b>	<b>153,654,764</b>

Aty ku mjetet financiare regjistrohen me vlerën e drejtë, shumat e pasqyruara tregojnë ekspozimin aktual të riskut të kredisë, por jo ekspozimin maksimal të riskut i cili mund të rezultojë në të ardhmen si rezultat i ndryshimeve të vlerës. Banka i mundëson klientëve të saj garanci të cilat mund të kërkojnë që Banka të kryejë pagesa në përfitim të tyre dhe të ndërmarrë angazhime për të shtrirë më tej linjat e kredisë për të siguruar nevojat e tyre të likuiditetit. Letër kreditë dhe garancitë e angazhojnë Bankën në kryerjen e pagesave në përfitim të klientëve në rast të një akti specifik, përgjithësisht i lidhur me importin dhe eksportin e mallrave, garancitë e pagesave dhe kontratës. Të tilla angazhime e ekspozojnë Bankën në risqe kredie të ngjashme, të cilat zbuten nga të njëjtat procedura dhe politika kontrolli. Çdo muaj Banka vlerëson angazhimet e saj financiare për ndonjë zhvlerësim të mundshëm. Subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësime të mundshme të këtyre angazhimeve janë huatë e klientëve me probleme ose huatë e atyre klientëve që janë ristrukturuar.

#### 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

##### (a) Risku i kredisë (vazhdim)

###### Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare

Tabelat e mëposhtme tregojnë cilësinë e kredisë të aktiveve financiare të cilat janë të ekspozuara ndaj riskut të kredisë në bazë të klasifikimeve të brendshme të Bankës. Kategoria e mëposhtme e huave në ndjekje përfshin ekspozimet që kanë një vonesë prej më shumë se 90 ditë dhe janë zhvlerësuar në mënyrë kolektive. Zhvlerësimi kolektiv është shpërndarë sipas normës standarde të grupit me karakteristika të ngjashme të riskut të kredisë ku bëjnë pjesë klientët.

Aktivitetet financiare në tabelat e mëposhtme paraqiten bruto pa zbritjet për zhvlerësimet për të dy vitet financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

31 dhjetor 2017	As me vonesë as të zhvlerësuara individualisht	Me vonesë por jo të zhvlerësuara individualisht	Individuali sht të zhvlerësua ra	Totali
Mjete monetare dhe të ngjashme (pa përfshirë arkën)	21,585,207	-	-	21,585,207
Hua dhe paradhënie bankave	20,171,066	-	-	20,171,066
Hua tregtare	36,587,751	296,010	2,614,224	39,497,985
Hua hipotekore	6,516,287	365,363	305,318	7,186,968
Hua konsumatore	1,792,917	64,054	362	1,857,333
Hua dhe paradhënie klientëve:	<u>44,896,955</u>	<u>725,427</u>	<u>2,919,904</u>	<u>48,542,286</u>
	<b>86,653,228</b>	<b>725,427</b>	<b>2,919,904</b>	<b>90,298,559</b>
Shoqëri të Listuara	6,771,662	-	-	6,771,662
Shoqëri jo të Listuara	2,651,346	-	-	2,651,346
Aktive financiare- letra me vlerë të vendosjes:	<u>9,423,008</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>9,423,008</u>
Shoqëri të Listuara	4,267,587	-	-	4,267,587
Letra me vlerë të qeverisë	44,842,532	-	-	44,842,532
Aktive financiare- letra me vlerë të investimit:	<u>49,110,119</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>49,110,119</u>
<b>Totali</b>	<b>145,186,355</b>	<b>725,427</b>	<b>2,919,904</b>	<b>148,831,686</b>
31 dhjetor 2016	As me vonesë as të zhvlerësuara individualisht	Me vonesë por jo të zhvlerësuara individualisht	Individualis ht të zhvlerësuar a	Totali
Mjete monetare dhe të ngjashme (pa përfshirë arkën)	25,968,849	-	-	25,968,849
Hua dhe paradhënie bankave	17,106,968	-	-	17,106,968
Hua tregtare	31,954,224	365,585	4,719,307	37,039,116
Hua hipotekore	5,931,119	647,781	468,523	7,047,423
Hua konsumatore	1,107,970	44,177	1,277	1,153,424
Hua dhe paradhënie klientëve:	<u>38,993,313</u>	<u>1,057,543</u>	<u>5,189,107</u>	<u>45,239,963</u>
	<b>82,069,130</b>	<b>1,057,543</b>	<b>5,189,107</b>	<b>88,315,780</b>
Shoqëri të Listuara	6,163,714	-	-	6,163,714
Shoqëri jo të Listuara	1,087,734	-	-	1,087,734
Aktive financiare- letra me vlerë të vendosjes:	<u>7,251,448</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>7,251,448</u>
Shoqëri të Listuara	5,071,447	-	-	5,071,447
Letra me vlerë të qeverisë	45,657,986	-	-	45,657,986
Aktive financiare- letra me vlerë të investimit:	<u>51,863,186</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>51,863,186</u>
<b>Totali</b>	<b>131,484,326</b>	<b>1,090,334</b>	<b>7,890,163</b>	<b>140,464,823</b>

#### 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

##### (a) Risku i kredisë (vazhdim)

###### Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

Huatë dhe paradhëniet klientëve janë e vetmja kategori e aktiveve financiare që kanë grupin e huave në ndjekje, të cilat jo domosdoshmërisht janë subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësim. Gjatë vitit 2016, Banka ka zbatuar "Udhëzimin e ri të Grupit mbi rregullat dhe kriteret për klasifikimin e ekspozimit të kredisë për qëllime konsolidimi" duke klasifikuar huatë në katër kategori kryesore a) hua pa probleme; b) në ndjekje c) të ristrukturuara; d) të dyshimta.

Vlerësimet për zhvlerësim bëhen në përputhje me Manualin e ISP për Vlerësimin Individual sipas të cilës kategoria e huave pa probleme zhvlerësohet kolektivisht, ndërsa tre kategoritë e tjera zhvlerësohen individualisht ose kolektivisht.

Për të gjitha kategoritë në ndjekje aplikohet një prag i rëndësishëm, në bazë të të cilit kryhet vlerësimi individual për zhvlerësim për të gjitha ekspozimet të cilat e kalojnë prahun. Vlerësimi sipas portofolit duke përdorur qasjen statistikore për zhvlerësim, aplikohet për kategoritë në ndjekje të cilat nuk e tejkalojnë prahun në fjalë.

Në tabelat e mëposhtme paraqitet analiza e ndjekjes së huave me vonesa të cilat nuk janë zhvlerësuar individualisht më 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>Më pak se 30 ditë</b>	<b>31 deri në 60 ditë</b>	<b>61 deri në 90 ditë</b>	<b>Totali</b>
Hua dhe paradhënie klientëve:				
Hua tregtare	35,902,643	406,203	278,905	36,587,751
Hua hipotekore	6,259,560	143,697	113,030	6,516,287
Hua konsumatore	1,755,114	24,798	13,005	1,792,917
<b>Totali</b>	<b>43,917,317</b>	<b>574,698</b>	<b>404,940</b>	<b>44,896,955</b>

<b>31 dhjetor 2016</b>	<b>Më pak se 30 ditë</b>	<b>31 deri në 60 ditë</b>	<b>61 deri në 90 ditë</b>	<b>Totali</b>
Hua dhe paradhënie klientëve:				
Hua tregtare	31,417,303	217,310	313,855	31,948,468
Hua hipotekore	1,080,203	21,414	7,259	1,108,876
Hua konsumatore	5,533,373	293,809	108,787	5,935,969
<b>Totali</b>	<b>38,030,879</b>	<b>532,533</b>	<b>429,901</b>	<b>38,993,313</b>

<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>91 deri në 180 ditë</b>	<b>më shumë se 180 ditë</b>	<b>Totali</b>
Hua dhe paradhënie klientëve:			
Hua tregtare	5,050	290,960	296,010
Hua hipotekore	126,307	239,056	365,363
Hua konsumatore	19,297	44,757	64,054
<b>Totali</b>	<b>150,654</b>	<b>574,773</b>	<b>725,427</b>

<b>31 dhjetor 2016</b>	<b>91 to 180 days</b>	<b>more than 180 days</b>	<b>Total</b>
Hua dhe paradhënie klientëve:			
Hua tregtare	6,900	358,685	365,585
Hua hipotekore	146,572	501,209	647,781
Hua konsumatore	14,411	29,766	44,177
<b>Totali</b>	<b>167,883</b>	<b>889,660</b>	<b>1,057,543</b>

## 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

### (a) Risku i kredisë (vazhdim)

#### Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

##### Huatë dhe letrat me vlerë të zhvlerësuara

Huatë dhe letrat me vlerë të zhvlerësuara janë ato për të cilat Banka vlerëson se mund të mos jetë në gjendje të mbledhë principalin dhe interesin e arkëtueshëm sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes (marrëveshjeve) së huasë. Banka i klasifikon huadhëniet dhe parapagimet ndaj klientëve në kategori pa probleme dhe me probleme sikundër përshkruhet më lart dhe kryen teste të zhvlerësimit për të gjitha huadhëniet që shfaqin prova objektive për zhvlerësim, duke vlerësuar të skontuar fluksin e ardhshëm të parasë dhe duke e krahasuar me shumën e mbetur për huatë respektive. Brenda kategorive me probleme, ekspozimet individuale të rëndësishme janë objekt i vlerësimit individual për zhvlerësim. Ndërsa për ekspozimet me probleme të cilat nuk janë të rëndësishme, zhvlerësimi kryhet në bazë të portofolit. Huatë që nuk shfaqin prova objektive për zhvlerësimin individual zhvlerësohen kolektivisht duke përdorur të dhënat për datat vjetore për mospagesë, normat e humbjes dhe periudhën e konfirmimit të humbjes të përgatitura nga Banka për grupet e huave me karakteristika të ngjashme. Zhvlerësimi kolektiv aplikohet edhe për ekspozimet e rëndësishme individuale, rikuperimi i plotë i tyre pritet të realizohet në bazë të metodës së zhvlerësimit individual si dhe për ekspozimet e testuar individualisht, por që kanë rezultuar të mos kenë nevojë për zhvlerësim individual.

Procesi i testimit për zhvlerësimin për çdo letër me vlerë të rëndësishme individualisht, të shprehur në monedhë të huaj, nxitet nëse vlera e drejtë është më e vogël se vlera kontabël ose nëse emetuesi shkel detyrimet e tij debitore ose dështon në pagesa kur paraqitet një procedurë falimentimi ose një dështim në pagesat e interesit ose të principalit. Kur ndodh një nga këto ngjarje, duke marrë në konsideratë peshën dhe pakthyeshmërinë e situatës, duhet të regjistrohet direkt një humbje nga zhvlerësimi. Nëse vlera e drejtë nuk është më shumë se 20% më pak se vlera kontabël neto dhe nuk janë identifikuar tregues të tjerë zhvlerësimi, nuk kryhet test i mëtejshëm i zhvlerësimit.

Testi i zhvlerësimit kryhet sipas rregullave të përcaktuara në politikën kontabël të ISP Group.

Zhvlerësimi kolektiv dhe individual sipas portofolit janë mënyra zhvlerësimi të cilat bazohen në metoda statistikore duke përdorur parametrat e riskut të kredisë që vlerësohen në bazë të të dhënave historike për grupe të ngjashme aktivesh.

##### Zbritjet për zhvlerësim

Banka përcakton një fond për humbjet nga zhvlerësimi i kredive që përfaqëson një përlogaritje për humbjet në portofolin e kredive.

Komponentët kryesorë të kësaj zbritjeje përfshijnë një komponent të humbjes specifike që lidhet me ekspozimet e rëndësishme individuale, si dhe me ekspozimet që zhvlerësohen kolektivisht dhe ekspozimet më pak të rëndësishme dhe një zbritje për humbjet në huatë e vlerësuara kolektivisht, të vendosura për grupe aktivesh homogjene në lidhje me humbjet që kanë ndodhur por që nuk janë identifikuar në huatë si objekt i vlerësimit individual për zhvlerësim.

Tabela më poshtë tregon ekspozimin neto të huave dhe paradhënive për klientët e klasifikuar në dy grupe kryesore: individualisht ose kolektivisht të zhvlerësuara.

Individualisht të zhvlerësuara	Ekspozimi Neto i huave dhe paradhënive klientëve	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shuma bruto	2,919,904	5,189,107
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(1,368,266)	(2,139,442)
<b>Vlera kontabël</b>	<b>1,551,638</b>	<b>3,049,665</b>
<b>Kolektivisht të zhvlerësuara</b>		
Shuma bruto	45,622,382	40,050,856
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(616,767)	(558,370)
<b>Vlera kontabël</b>	<b>45,005,615</b>	<b>39,492,486</b>
<b>Total i vlerës kontabël të huave dhe paradhënive për klientët</b>	<b>46,557,253</b>	<b>42,542,151</b>

#### 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

##### (a) Risku i kredisë (vazhdim)

###### Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

Lëvizjet për zhvlerësimet individuale dhe kolektive janë paraqitur në Shënimin 11. Më poshtë paraqitet një analizë e shumave bruto dhe neto (e zbritjeve për zhvlerësime) për huatë e zhvlerësuara individualisht sipas klasifikimit të riskut:

	Hua dhe paradhënie klientëve individualisht të zhvlerësuara	
	Bruto	Neto
<b>31 dhjetor 2017</b>		
Pa probleme	-	-
Në ndjekje	-	-
Të strukturuar	2,201,187	1,162,624
Të dyshimta	718,717	389,014
<b>Totali</b>	<b>2,919,904</b>	<b>1,551,638</b>
<b>31 dhjetor 2016</b>		
Pa probleme	-	-
Në ndjekje	108,100	85,903
Të strukturuar	3,005,664	1,649,999
Të dyshimta	2,075,343	1,313,763
<b>Totali</b>	<b>5,189,107</b>	<b>3,049,665</b>

Më poshtë paraqitet vlera e mbartur e huave të strukturuar pa zbritjet për zhvlerësimin, sipas produktit:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Hua tregtare	2,194,366	1,560,093
Hua hipotekore	145,679	148,285
Hua konsumatore	543	-
<b>Totali</b>	<b>2,340,588</b>	<b>1,708,378</b>

###### Politikat e fshirjes nga librat kontabël

Banka fshin nga librat një huadhënie (dhe zbritjet për zhvlerësime nga humbje të lidhura me të) kur Këshilli Drejtues i Bankës përcakton se kredia është e paarkëtueshme. Ky vendim arrihet pas marrjes në konsideratë të informacionit për ndodhjen e ndryshimeve të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit, në mënyrë të tillë që huamarrësi nuk paguan dot më detyrimet ose kolaterali nuk do të jetë i mjaftueshëm për të shlyer të gjithë ekspozimin dhe huaja klasifikohet në kategorinë e huave të humbura për arsye të raportimit rregullator për një periudhë prej të paktën 3 vjet. Politika e Bankës është gjithashtu në përputhje me Rregulloren e ndryshuar nr. 62, datë 14/09/2011 "Për Administrimin e Riskut të Kredisë për Bankat dhe Degët e Bankave të Huaja".

Fluksi i parashikuar i të ardhurave nga kolaterale dhe/ose garancive që mbulojnë ekspozimet përbëjnë zakonisht burimin kryesor të fluksit të të ardhurave në të ardhmen për linjat e kredisë me probleme. Disa nga parametrat e vlerësimit të përdorura për llogaritje janë:

- *Vlera e realizueshme e kolateraleve*, e cila përllogaritet duke ulur vlerën e tregut të kolateraleve të vlerësuara me një 'faktor skontimi'. Kjo e fundit merr në konsideratë karakteristikat e grupeve të ngjashme të kolateraleve, e cila nënkupton vlerën mesatare të rikuperueshme të një kolaterali të caktuar, bazuar në eksperiencën e Bankës të procesit të rikuperimit të kolateraleve.
- *Koha e flukseve të parashikuara të parasë*, e cila i referohet kohës së pritshme të rikuperimit (në vite) të një lloji të caktuar kolaterali.

Kostot e rikuperimit zbriten nga fluksi i ardhshëm i parashikuar i parasë. Kolaterali përgjithësisht nuk mbahet për huatë dhe paradhëniet ndaj institucioneve financiare, përveç kur instrumentet financiare mbahen si pjesë e marrëveshjeve të ndërsjellta dhe aktivitetit të huamarrjes nëpërmjet instrumenteve financiare. Zakonisht, pengi nuk mbahet kundrejt instrumenteve të investimit, dhe asnjë peng i tillë nuk është mbajtur në 31 dhjetor 2017 ose 2016. Parashikimet për vlerën e drejtë janë të bazuara në vlerën e kolateraleve të vlerësuara në momentin e marrjes së borxhit, dhe janë gjithashtu të rishikueshme çdo tre vjet.

#### 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

##### (a) Risku i kredisë (vazhdim)

Një përlogaritje e vlerës së drejtë të paskontuar dhe të skontuar të kolateraleve dhe instrumenteve të tjerë garantues, të mbajtur kundrejt aktiveve financiare tregohet më poshtë:

	Kolaterale për huatë dhe paradhëniet klientëve 31 dhjetor 2017		Kolaterale për huatë dhe paradhëniet klientëve 31 dhjetor 2016	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto
<b>Ndaj të zhvlerësuarave Individualisht</b>				
Ndërtesa	6,141,972	1,904,991	10,509,462	3,117,472
Letra me vlerë të borxhit	-	-	729,694	88,135
Pengje & Garanci	1,330	532	94,414	8,778
Të tjera	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>6,143,302</b>	<b>1,905,523</b>	<b>11,333,570</b>	<b>3,214,385</b>
<b>Vlera kontabël Neto</b>		<b>1,551,638</b>		<b>3,049,665</b>

Shuma bruto e kolateralit përfshin vlerën e kolateralit përpara testimit të huave individualisht të zhvlerësuar. Shuma neto tregon vlerën e aktualizuar të njëjtit kolateral pas këtij testi.

##### Zbritjet për zhvlerësim

Tabela më poshtë tregon totalin e kolateraleve për huadhëniet e vlerësuar në kategorinë e zhvlerësimit kolektiv. Këto kolaterale nuk kalojnë në të njëjtën procedurë testimi si grupi më sipër. Informacioni në tabelën e mëposhtme tregon se sa janë të siguruara huatë dhe paradhëniet e klientëve të zhvlerësuar kolektivisht ndaj kolateralit përkatës të tyre.

	Kolaterale për Huatë dhe paradhëniet klientëve 31 dhjetor 2017		Kolaterale për Huatë dhe paradhëniet klientëve 31 dhjetor 2016	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto
<b>Ndaj të zhvlerësuarave Kolektivisht</b>				
Ndërtesa	71,179,138	31,964,510	67,976,883	29,985,533
Pengje & Garanci	9,862,177	4,612,244	8,170,061	3,643,476
Mjete monetare	1,253,774	1,210,692	1,268,998	1,226,859
Letra me vlerë të borxhit	3,259,239	1,106,704	4,546,960	1,487,527
Të tjera	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>85,554,328</b>	<b>38,894,150</b>	<b>81,962,902</b>	<b>36,343,395</b>
<b>Vlera kontabël</b>		<b>45,005,615</b>		<b>39,492,486</b>

Banka ka si politikë që të mos mbajë aktivet që merr nëpërmjet procesit të rikuperimit. Vlerat që mbliidhen nga të ardhurat e shitjes së aktivitetit përdoren për të zvogëluar ose shlyer vlerën e mbartur të huave me probleme.

Në rastin e kolateraleve në pronësi të Bankës, konvertimi në para është qëllimi kryesor i Bankës, e cila ndërmerr një marketing të mirëfilltë për shitjen. Nëse nuk ka asnjë ofertë të mirë të mbledhur deri në një moment të caktuar, Banka ka si procedurë të mbajë aktivin në inventarët e saj për shitje deri sa të marrë ofertën më të mirë. Vlera e aktiveve afatgjata materiale të riposduara janë paraqitur në shënimin 15. Në varësi të nevojave operacionale të Bankës dhe përshtatshmërisë së aktivitetit për t'i plotësuar ato nevojat, Drejtimi vendos ta vere në përdorim atë, rrjedhimisht bëhet një riklasifikim në aktivet në përdorim të Bankës (shih shënimin 12).

#### 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

##### (a) Risku i kredisë (vazhdim)

Banka monitoron përqendrimet e riskut të kredisë sipas sektorëve dhe vendit. Analiza e riskut të kredisë në datën e raportimit paraqitet si më poshtë:

	<b>Hua dhe paradhënie klientëve, neto</b>	
<b>Përqendrimi sipas sektorëve</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Shërbimet	19,654,305	17,012,528
Shitja me shumicë	8,195,500	9,016,937
Ndërtimi	2,486,583	2,802,533
Prodhimi	5,083,994	4,501,193
Pronat e patundshme	392,543	113,078
Të tjera	2,083,305	1,289,844
<b>Korporatat</b>	<b>37,896,230</b>	<b>34,736,113</b>
Kredi hipotekore	6,910,762	6,721,178
Konsumatore	1,750,261	1,084,860
<b>Individët</b>	<b>8,661,023</b>	<b>7,806,038</b>
<b>Vlera kontabël</b>	<b>46,557,253</b>	<b>42,542,151</b>
	<b>Hua dhe paradhënie bankave</b>	
<b>Përqendrimi sipas sektorëve</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Banka	20,171,066	17,106,968
<b>Vlera kontabël</b>	<b>20,171,066</b>	<b>17,106,968</b>
	<b>Investime financiare</b>	
<b>Përqendrimi sipas sektorëve</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Qeveri Qendrore	56,522,515	55,554,462
Banka	900,577	1,789,549
Institucione të tjera financiare	1,110,035	636,870
<b>Vlera kontabël</b>	<b>58,533,127</b>	<b>57,980,881</b>

Cilësia e kredisë së ekspozimit maksimal të kredisë të letrave me vlerë të borxhit bazuar në vlerësimet dhe klasifikimin e agjencisë Moody's, nëse zbatohet, paraqitet si më poshtë:

	<b>Instrumente financiare (letra me vlerë të borxhit)</b>	
<b>Qeveri Qendrore</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Klasifikimi Aaa	-	-
Klasifikimi Aa1	-	404,876
Klasifikimi Baa2	6,235,713	6,266,433
Klasifikimi B1	50,286,802	48,883,153
	<b>56,522,515</b>	<b>55,554,462</b>
<b>Institucionet financiare</b>		
Klasifikimi Aaa	2,010,612	2,261,888
Klasifikimi Baa2	-	164,531
	<b>2,010,612</b>	<b>2,426,419</b>
<b>Totali i Vlerës kontabël</b>	<b>58,533,127</b>	<b>57,980,881</b>



#### 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

##### (a) Risku i kredisë (vazhdim)

###### Përqendrimi i riskut të kredisë

Portofoli i riskut të kredisë të Bankës karakterizohet nga përqendrimet e mëposhtme të riskut të kredisë.

	31 dhjetor 2017	Ekspozimi në %	31 dhjetor 2016	Ekspozimi në %
Letrat me vlerë të Republikës së Shqipërisë	50,286,798	34%	48,883,153	34%
Llogaritë me Bankën Qendrore	12,364,287	8%	12,235,288	9%
<b>Totali i riskut direkt të Qeverisë Shqiptare</b>	<b>62,651,085</b>	<b>42%</b>	<b>61,118,441</b>	<b>43%</b>
Banka më e madhe	13,647,540	9%	13,224,058	9%
Klienti më i madh	5,452,997	4%	5,715,588	4%
<b>Totali i riskut të bankës më të madhe dhe klientit më të madh</b>	<b>19,100,537</b>	<b>13%</b>	<b>18,939,646</b>	<b>13%</b>
<b>Totali i riskut në bilanc</b>	<b>81,751,622</b>	<b>55%</b>	<b>80,058,087</b>	<b>56%</b>

Ekspozimi më i madh i bankës është me Grupin dhe klienti më i madh është një Shoqëri me pronësi shtetërore.

###### Risku i shlyerjes

Aktivitetet e Bankës mund të krijojnë risk në kohën e shlyerjes së transaksioneve dhe tregtimit. Risku i shlyerjes është risku i humbjes për shkak të dështimit të një Shoqërie për të shlyer detyrimet për dhënien e parasë në dorë, letrave me vlerë ose aktiveve të tjera sipas marrëveshjes kontraktuale. Risku i shlyerjes me institucione financiare dhe partnere qeveritar përfshihet brenda një sistemi kufizimesh për të gjitha transaksionet me këta partnere dhe është objekt i monitorimit të përditshëm, sikundër përcaktohet dhe rregullohet në rregulloren e brendshme "Limitet e ISBA për palët Institucione Financiare" dhe në rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e riskut nga ekspozimet e mëdha të bankave".

Rregullorja e Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e riskut nga ekspozimet e mëdha të bankave" u rishikua gjatë vitit 2014 dhe hyri në fuqi në mars 2015. Banka ka rezultuar brenda kufijve në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë deri më 15 dhjetor 2017.

Me qëllim parandalimin e çdo shkelje të kufijve të kundërpartive lokale me institucionet financiare, të krijuara nga luhatjet e kursit të këmbimit, banka ka integruar kufijtë e nivelit paralajmërues (kufijtë e butë), 23.4% të kapitalit rregullator për ekspozimet ndaj Grupit ISP dhe 18.7% të kapitalit rregullator për ekspozimet ndaj institucioneve/qeverive të tjera financiare, të miratuara nga FRCO më 24 janar 2017.

Gjatë vitit 2017, është raportuar një shkelje e limitit të butë në lidhje me ekspozimin e ISP në nivelin 23.44% (kufiri 23.4%). Banka zvogëloi gjendjen e nostro-ve dhe respektoi brenda ditës së nesërme limitin.

## 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

### (b) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është përcaktuar si paaftësia e mundshme e një institucioni për të plotësuar detyrimet që ka për pagesa për shkak të paaftësisë për të likuiduar aktive ose për të siguruar financim të mjaftueshëm nga tregu (risku i likuiditetit nga financimi), ose për shkak të vështirësive që lidhen me konvertimin e pozicionit të aktiveve financiare që shoqërohen me ndryshime të rëndësishme negative të çmimeve, për shkak të kushteve të papërshtatshme ose çrregullimeve të përkohshme të tregut.

#### Administrimi i riskut të likuiditetit

Metoda e Bankës për administrimin e likuiditetit është të sigurojë sa më shumë të jetë e mundur, që do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj në kohë, si në kushte normale ashtu edhe në kushte jonormale, pa pësuar humbje të papranueshme ose që rrezikojnë dëmtimin e reputacionit të Bankës. Banka përcakton udhëzimet për administrimin e riskut të likuiditetit dhe një plan emergjence të cilat janë objekt i rishikimit nga strukturat e Grupit, dhe aprovimi nga Komiteti i Riskut Financiar të ISBA dhe Këshilli Drejtues. Departamenti i Thesarit dhe Tregut të Kapitalit është përgjegjës për administrimin e likuiditetit dhe Divizioni i Administrimit të Riskut është përgjegjës për monitorimin e treguesve dhe verifikimin e zbatimit të limiteve.

Në 2017 banka ka përditësuar rregulloren e saj për Administrimin e Riskut të Likuiditetit, miratuar nga Bordi i Drejtorëve në shtator 2017. Në politikën e re zbatohen dispozitat rregullatore më të fundit të cilat parashikohen në rregulloren e njohur si “Rregullorja e Deleguar” dhe janë miratuar nga Komiteti i Bazelit (Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare, Tetor 2014).

Banka monitoron likuiditetin, në përputhje me këtë rregullore, që të administrojë detyrimet e saj kur duhen realizuar si dhe që të aktivizojë procedura emergjence në rast përshkallëzimi.

Një raport i balancuar duhet të ruhet midis burimeve hyrëse dhe fluksit në dalje, si në planin afatshkurtër dhe në atë afatmesëm dhe afatgjatë. Objektivi është organizuar sipas përdorimit të metrikave specifike që vijojnë më poshtë “Raporti i Mbulimit të Likuiditetit afatshkurtër deri në 30 ditë” dhe “Raporti i financimit të qëndrueshëm”.

- **Raporti i Mbulimit të Likuiditetit (LCR)** deri në 30 ditë: ka si qëllim të ruaj një nivel të mjaftueshëm të aktiveve të lira likuide me cilësi të lartë (QHLA) për të përmbushur nevojat për likuiditetin afat-shkurtër në rastin e skenarit të stresit të likuiditetit. ( $LCR \geq 90\%$ ).
- **Raporti i financimit të qëndrueshëm (NSFR):** ka si qëllim të garantojë një pozicion të përshtatshëm likuiditeti për një periudhë afat-mesme/afatgjate. Ai përcakton një vlerë minimale të pranueshme financimi për një periudhë kohore një vjeçare në lidhje me nevojat që rezultojnë nga karakteristikat e likuiditetit dhe afatet e maturimit të aktiveve dhe ekspozimeve jashtë bilancit ( $NSFR \geq 90\%$ ).

Mbajtja e rezervave të aktiveve likuide (e njohur si “Zbutës i Likuiditetit”) është një nga mjetet kryesore për zbutjen e riskut të likuiditetit. Për identifikimin dhe matjen e këtij risku, afatmesëm dhe afatgjatë, klasifikimi i aktiveve shumë likuide merr një rëndësi domethënëse.

Në politikën e likuiditetit, Banka ka projektuar një tregues të Raportit të Mbulimit të Likuiditetit (LCR) për një periudhë deri në 3 muaj duke përfshirë efektin e parashikuar në treg të problemeve akute për likuiditet (në nivel banke) e kombinuar me një krizë të gjerë dhe të përgjithshme tregu, bazuar në supozimet e përcaktuara në udhëzimet e Grupit

Një llogaritje e ngjashme por jo e njëjtë përdoret për të vlerësuar përputhshmërinë e Bankës me limitet e likuiditetit të vendosur nga Banka e Shqipërisë, e cila në të gjitha monedhat duhet të jetë mbi 20% dhe mbi 15% veçmas për monedhën vendase dhe monedhat e huaja. Rregullorja e Bankës së Shqipërisë parashikon që Banka ti mbajë 10% të depozitave të saj me maturim jo më pak se 2 vjet si një rezervë e detyrueshme me Bankën Qendrore.

Të gjitha raportet e sipërpërmendura të likuiditetit të bankës monitorohen në mënyrë periodike nga Banka në lidhje me limitet e brendshme dhe udhëzimet e Grupit dhe të Bankës Qendrore.

## 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

### (b) Risku i likuiditetit (vazhdim)

Niveli i likuiditetit të bankës, matur përmes treguesve të LCR dhe NSFR, është i barabartë me 771% për LCR dhe i barabartë me 223% për NSFR më 31 dhjetor 2017 (Dhjetor 2016: LCR = 811% dhe NSFR = 228%). Ndërkohë, treguesit rregullatorë, në fund të dhjetorit 2017, janë në nivelet e: 48.4% për treguesit e likuiditetit në total, 96.6% në monedhën Lek dhe 23.6% në valutë të huaj (dhjetor 2016: treguesi i likuiditetit në total 50.2%, 96% në monedhën Lek dhe 24.8% në valutë të huaj). Gjatë vitit 2017, banka ka qenë brenda kufijve të brendshëm dhe limiteve rregullatorë.

Tabela më poshtë tregon situatën e likuiditetit të Bankës siç monitorohet aktualisht nga drejtimi i i Bankës, në bazë të rregullores së brendshme lokale dhe Udhëzimeve të Grupit për likuiditetin më 31 dhjetor 2017 dhe më 31 dhjetor 2016. Të dhënat nuk janë të rakordueshme duke qenë se janë paraqitur nga drejtimi dhe janë rregulluar siç paraqiten më poshtë.

Në konsideratë janë marrë flukset e parasë të pa skontuara brenda/jashtë Bankës për të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare në bilanc dhe jashtë bilancit, sipas maturitetit kontraktual dhe nuk reflekton supozimet për historikun e mbajtjes ose likuidimet përpara afatit. Këtu reflektohen supozimet e një skenari si: rezerva e likuiditetit – rezervat e linjës së parë, të dytë dhe të tretë, koeficientet e sjelljes që aplikohen për llogaritë rrjedhëse dhe paradhëniet e klientëve, si dhe përqindjet e tërheqjes për kategoritë jashtë bilancit si linja kredie dhe garanci depozitat në të parë dhe huatë në të parë ofruar klientëve dhe përqindjet e zbritura nga kategoritë e zërave jashtë bilancit si linjat e kredive dhe garancitë ku banka është e angazhuar.

	deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vjet	> 5 vjet	Totali
<b>31 dhjetor 2017</b>						
<b>Aktive (Fluksi i mjeteve monetare hyrëse)</b>	<b>68,641,423</b>	<b>22,454,255</b>	<b>15,102,287</b>	<b>39,180,519</b>	<b>10,369,030</b>	<b>155,747,514</b>
Arka neto	1,293,078	-	-	-	-	1,293,078
Kërkesat minimale për rezervën	-	-	-	11,836,076	-	11,836,076
Paradhënie bankave	10,229,246	-	-	-	-	10,229,246
Letra me vlerë të investimit dhe letra me vlerë të vendosjes – rezervat e linjës së parë	43,765,534	-	-	-	-	43,765,534
Letra me vlerë të investimit dhe letra me vlerë të vendosjes – rezervat e linjës së dytë	-	-	-	-	-	-
Letra me vlerë të investimit dhe letra me vlerë të vendosjes – rezervat e linjës së tretë	93,544	12,118,492	1,446,639	4,229,310	294,210	18,182,195
Hua Bankave	5,295,204	7,695,960	6,178,135	-	-	19,169,299
Hua dhe paradhënie klientëve (hua bruto pa probleme)	7,964,817	2,639,803	7,477,513	23,115,133	10,074,820	51,272,086
<b>31 dhjetor 2017</b>						
<b>Detyrime (Fluksi i mjeteve monetare dalëse)</b>	<b>(17,962,597)</b>	<b>(16,256,847)</b>	<b>(37,313,269)</b>	<b>(59,491,064)</b>	<b>(689,714)</b>	<b>(131,713,491)</b>
Depozita nga bankat dhe klientët - llogari rrjedhëse	(11,652,627)	(5,363,986)	(11,641,568)	(49,849,317)	-	(78,507,498)
<i>Llogari rrjedhëse me bankat</i>	(866,149)	-	-	-	-	(866,149)
<i>Llogari rrjedhëse me klientët</i>	(10,786,478)	(5,363,986)	(11,641,568)	(49,849,317)	-	(77,641,349)
Depozita nga bankat	(2,419,529)	-	-	-	-	(2,419,529)
Depozita nga klientët - Depozita me afat	(3,890,441)	(10,892,861)	(25,671,701)	(9,641,747)	(689,714)	(50,786,464)
<b>Pozicioni neto për zërat e bilancit</b>	<b>50,678,826</b>	<b>6,197,408</b>	<b>(22,210,982)</b>	<b>(20,310,545)</b>	<b>9,679,316</b>	<b>24,034,023</b>
Zëra Jashtë Bilancit (Flukse Monetare Hyrëse)	-	-	-	-	-	-
Zëra Jashtë Bilancit (Flukse Monetare Dalëse)	(362,239)	-	-	-	-	(362,239)
Pozicioni neto për zëra jashtë bilancit	(362,239)	-	-	-	-	(362,239)
<b>Pozicioni neto 31 dhjetor 2017</b>	<b>50,316,587</b>	<b>6,197,408</b>	<b>(22,210,982)</b>	<b>(20,310,545)</b>	<b>9,679,316</b>	<b>23,671,784</b>
<b>Pozicioni neto i akumuluar më 31 dhjetor 2017</b>	<b>50,316,587</b>	<b>56,513,995</b>	<b>34,303,013</b>	<b>13,992,468</b>	<b>23,671,784</b>	

#### 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

##### (b) Risku i likuiditetit (vazhdim)

	deri ne 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vjet	> 5 vjet	Totali
<b>31 dhjetor 2016</b>						
<b>Aktivet (Fluksi i mjeteve monetare hyrëse)</b>	<b>75,259,512</b>	<b>20,021,699</b>	<b>13,299,182</b>	<b>35,543,560</b>	<b>8,191,195</b>	<b>152,315,148</b>
Arka neto	1,302,925	-	-	-	-	1,302,925
Kërkesat minimale për rezervën	1,312,852	-	-	11,522,585	-	12,835,437
Paradhënie bankave	12,457,383	-	-	-	-	12,457,383
Letra me vlerë të investimit dhe letra me vlerë të vendosjes – rezervat e linjës së parë	46,383,198	-	-	-	-	46,383,198
Letra me vlerë të investimit dhe letra me vlerë të vendosjes – rezervat e linjës së tretë	154,400	11,320,024	1,310,494	3,224,737	429,226	16,438,881
Hua Bankave	6,070,335	6,795,073	5,628,130	-	-	18,493,538
Hua dhe paradhënie klientëve (hua bruto pa probleme)	7,578,419	1,906,602	6,360,558	20,796,238	7,761,969	44,403,786
<b>31 dhjetor 2016</b>	<b>Up to 1 month</b>	<b>1-3 months</b>	<b>3-12 months</b>	<b>1-5 years</b>	<b>&gt; 5 years</b>	<b>Total</b>
<b>Detyrime (Fluksi i mjeteve monetare dalëse)</b>	<b>(19,720,276)</b>	<b>(14,944,682)</b>	<b>(40,626,395)</b>	<b>(54,227,214)</b>	<b>(29,531)</b>	<b>(129,548,098)</b>
Depozita nga bankat dhe klientët - llogari rrjedhëse	(11,070,674)	(5,143,480)	(11,039,376)	(45,139,051)	-	(72,392,581)
<i>Llogari rrjedhëse me bankat</i>	(1,008,354)	-	-	-	-	(1,008,354)
<i>Llogari rrjedhëse me klientët</i>	(10,062,320)	(5,143,480)	(11,039,376)	(45,139,051)	-	(71,384,227)
Depozita nga bankat	(1,886,323)	-	-	-	-	(1,886,323)
Depozita nga klientët - Depozita me afat	(6,763,279)	(9,801,202)	(29,587,019)	(9,088,163)	(29,531)	(55,269,194)
<b>Pozicioni neto për zërat e bilancit</b>	<b>55,539,236</b>	<b>5,077,017</b>	<b>(27,327,213)</b>	<b>(18,683,654)</b>	<b>8,161,664</b>	<b>22,767,050</b>
Zëra Jashtë Bilancit (Flukse Monetare Hyrëse)	-	-	-	-	-	-
Zëra Jashtë Bilancit (Flukse Monetare Dalëse)	(250,025)	-	-	-	-	(250,025)
<b>Pozicioni neto për zëra jashtë bilancit</b>	<b>(250,025)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(250,025)</b>
<b>Pozicioni neto më 31 dhjetor 2016</b>	<b>55,289,211</b>	<b>5,077,017</b>	<b>(27,327,213)</b>	<b>(18,683,654)</b>	<b>8,161,664</b>	<b>22,517,025</b>
<b>Pozicioni neto i akumuluar 31 dhjetor 2016</b>	<b>55,289,211</b>	<b>60,366,228</b>	<b>33,039,015</b>	<b>14,355,361</b>	<b>22,517,025</b>	

#### 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

##### (b) Risku i likuiditetit (vazhdim)

Informacioni i siguruar lidhet me fluksin e parasë që vjen nga detyrimet financiare jashtë bilancit, kështu që ndryshon konsiderueshëm nga prezantimi në bilanc. Analiza nuk përfshin detyrimet jo financiare dhe kapitalin, dhe përfshin flukset e parasë me interes kontraktual.

Tabela më poshtë tregon detyrimet e kushtëzuara dhe angazhimet financiare të Bankës:

	1	1-3	3-12	1-5	>5	Totali
	Muaj	Muaj	Muaj	Vite	Vite	
<b>31 dhjetor 2017</b>						
Angazhime	5,832,819	-	-	-	-	<b>5,832,819</b>
Garanci	6,955,399	-	-	-	-	<b>6,955,399</b>
<b>31 dhjetor 2016</b>						
Angazhime	4,977,785	-	-	-	-	<b>4,977,785</b>
Garanci	5,020,668	-	-	-	-	<b>5,020,668</b>

Banka pret që vetëm një pjesë e vogël e angazhimeve të kërkohet brenda një muaji dhe garancitë të mbyllen sipas afatit të maturimit. (Referojuni dhe shënimit 30 Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara)

Rakordimi ndërmjet tabelës së maturitetit të angazhimeve dhe detyrimeve të kushtëzuara dhe shënimit 30 - Angazhimet dhe Detyrimet e Kushtëzuara është si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>Angazhime</b>	<b>5,832,819</b>	<b>4,977,785</b>
Hua të aprovuara jo të disbursuara	5,832,819	4,977,785
<b>Garanci</b>	<b>6,955,399</b>	<b>5,020,668</b>
Letër Kredi	3,025,244	355,827
Garanci në favor të klientëve	3,930,155	4,664,841

##### c) Risku i Tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, si norma e interesit, çmimet e kapitalit, kurset e këmbimit të monedhave të huaja, spread-et e kredisë (jo të lidhura me ndryshime të gjendjes së debitorit/kreditorit) do të ndikojnë fitimet e Bankës ose vlerën e mbajtjes së instrumenteve financiare. Objektivi i administrimit të riskut të tregut është të administrojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke maksimizuar kthimin mbi riskun.

## 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

### c) Risku i tregut (vazhdim)

#### Ekspozimi ndaj riskut të kursit të këmbimit

'Risku i kursit të këmbimit' përkufizohet si mundësia që luhatjet e kurseve të këmbimit të prodhojnë ndryshime të rëndësishme, si pozitive dhe negative në bilancin e Bankës. Burimet më të rëndësishme të riskut të normës së këmbimit konsistojnë në:

- Huadhëniet dhe depozitat në monedhë të huaj të korporatave dhe individëve;
- Investime në Letrat me vlerë në monedhë të huaj;
- Tregtimi i kartëmonedhave të huaja;
- Arkëtimi ose pagesa e interesit, komisioneve, kostove administrative, etj. në monedha të huaja

Ekspozimi i Bankës ndaj riskut të kursit të këmbimit monitorohet çdo ditë nga Departamenti i Riskut të Tregut dhe Operacional që siguron përputhshmëri me limitet e brendshme dhe rregullative. Rregulloret e brendshme caktojnë kufizime për çdo pozicion të hapur valutor, për pozicione të hapura globale, për humbje maksimale dhe Vlerën me Risk ("VaR"). Për konfirmimin/përcaktimin e limiteve të sipërpërmendura është kryer një analizë e detajuar e historikut të të dhënave për një periudhë një vjeçare. Kufizimet rregullative lokale i referohen një limiti maksimal prej 20 % të kapitalit rregulator për çdo pozicion të hapur valutor dhe 30% për pozicionin e përgjithshëm valutor.

Metodologjitë e vlerësimit për llogaritjen e VaR-it të përfshira në procedurat e brendshme janë të bazuara në teknikën simulimit për të dhënat historike të ponderuara. Peshat që përdoren në model janë caktuar duke përdorur një funksion eksponencial në rënie me një faktor skontues prej 0.992 dhe me një interval kohor prej 250 ditësh në përputhje me Udhëzimet e Grupit. VaR-i i vlerësuar në një nivel besimi prej 99% dhe periudhë mbajtjeje 1 ditore, ishte 0.85 milion Lek më 31 dhjetor 2017, me një mesatare përgjatë vitit prej 0.6 milion Lek (dhjetor 2016: 1.7 milion Lek dhe mesatarisht 0.9 milion Lek).

Modeli VaR është përcaktuar nga departamenti i riskut të tregut të bankës mëmë (ISP). Departamenti i riskut të ISP nuk ka kryer ende një testim historik të të dhënave për modelin VaR, si zotërues i tij. Niveli i VaR-it rezultoi brenda limitit për periudhën 2017 dhe 2016 dhe kufiri për ndalimin e humbjes rezultoi brenda limitit gjatë periudhës 2017 dhe 2016.

Banka ka ruajtur limitet gjatë vitit 2017 në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë.

Aktivitetet financiare në monedha të huaja janë të paraqitura në çdo shënim respektiv të pasqyrave financiare.

#### 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

##### c) Risku i tregut (vazhdim)

<b>Aktive</b>	<b>Lek</b>	<b>USD</b>	<b>EUR</b>	<b>Të tjera</b>	<b>Totali</b>
Mjete monetare dhe të ngjashme	2,014,710	5,371,312	13,869,975	1,621,867	22,877,864
Hua dhe paradhënie bankave	4,061,958	1,154,041	14,955,067	-	20,171,066
Letra me vlerë të vendosjes	506,750	1,665,257	6,905,646	345,355	9,423,008
Letra me vlerë të investimeve	44,842,533	2,194,854	2,072,732	-	49,110,119
Hua dhe paradhënie klientëve	15,895,159	1,472,124	29,189,918	52	46,557,253
Ndërtesa dhe pajisje	2,141,765	-	-	-	2,141,765
Aktive afatgjata jo-materiale	528,695	-	-	-	528,695
Aktive materiale afatgjata të investuara	575,318	-	-	-	575,318
Të drejta tatimore të shtyra	174,247	-	-	-	174,247
Të drejta tatimore afatshkurtra	389,883	-	-	-	389,883
Inventari dhe mjete të tjera	755,441	24,157	1,517,280	59	2,296,937
<b>Aktive gjithsej</b>	<b>71,886,459</b>	<b>11,881,745</b>	<b>68,510,618</b>	<b>1,967,333</b>	<b>154,246,155</b>
<b>Detyrimet</b>					
Detyrime ndaj bankave	4,079,009	-	1,069,235	20,539	5,168,783
Detyrime ndaj klientëve	47,318,723	11,882,062	66,608,759	1,901,781	127,711,325
Provizione	373,380	948	94,367	-	468,695
Detyrime të tjera	845,730	14,016	178,843	994	1,039,583
Detyrime tatimore të shtyra	148,327	-	-	-	148,327
Kapitali neto	19,643,524	(3,838)	69,630	126	19,709,442
<b>Detyrime dhe kapitali gjithsej</b>	<b>72,408,693</b>	<b>11,893,188</b>	<b>68,020,834</b>	<b>1,923,440</b>	<b>154,246,155</b>
<b>Pozicioni i hapur valutor neto më 31 dhjetor 2017 (1)-(2)</b>	<b>(522,234)</b>	<b>(11,443)</b>	<b>489,784</b>	<b>43,893</b>	<b>-</b>
Aktive jashtë bilancit	11,034,158	5,747,136	112,042,308	374,875	<b>129,198,477</b>
Detyrime jashtë bilancit	11,046,659	5,681,746	112,064,174	405,898	<b>129,198,477</b>
<b>Pozicioni valutor neto jashtë bilancit më 31 dhjetor 2017</b>	<b>(12,501)</b>	<b>65,390</b>	<b>(21,866)</b>	<b>(31,023)</b>	<b>-</b>
<b>Totali i pozicionit valutor neto më 31 dhjetor 2017</b>	<b>(534,735)</b>	<b>53,947</b>	<b>467,918</b>	<b>12,870</b>	<b>-</b>
Aktivitet në bilanc më 31 dhjetor 2016	69,219,049	13,173,906	65,601,856	1,533,008	<b>149,527,819</b>
Detyrimet në bilanc dhe kapitali më 31 dhjetor 2016	70,296,508	13,157,397	64,538,466	1,535,448	<b>149,527,819</b>
<b>Pozicioni valutor neto jashtë bilancit më 31 dhjetor 2016</b>	<b>66,169</b>	<b>30,547</b>	<b>(105,407)</b>	<b>8,691</b>	<b>-</b>
<b>Totali i pozicionit valutor neto më 31 dhjetor 2016</b>	<b>(1,011,290)</b>	<b>47,056</b>	<b>957,983</b>	<b>6,251</b>	<b>-</b>

## 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

### c) Risku i tregut (vazhdim)

#### Ekspozimi ndaj riskut të normës së interesit

Risku kryesor i normës së interesit ndaj të cilit janë të ekspozuar portfolet e Bankës është risku i humbjes nga luhatjet e flukseve të ardhshme të parasë ose vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e interesave të tregut. Risku krijohet fillimisht nga portfoli i letrave me vlerë, si edhe aktiviteti bankar i lidhur me korporatat dhe individët. Risku i normave të interesit administrohet kryesisht nëpërmjet monitorimit periodik të diferencave e shumave të normave të interesit midis aktiveve dhe detyrimeve të Bankës si dhe duke përgatitur skenarë analizash mbi normat e interesit për qëllime vendimmarrjeje.

Metoda e përdorur për llogaritjen e riskut të normës së interesit në aktivet dhe detyrimet e Bankës është analiza e zhvendosjes së ndjeshmërisë. Kjo matje e miratuar nga Banka duhet të sigurojë që profili i riskut të mund të shqyrtohet nga dy këndvështrime plotësuese të njëra tjetrës:

- Perspektiva e vlerës ekonomike (VEK - Vlera Ekonomike e Kapitalit), që vlerëson ndikimin e lëvizjeve të pafavorshme të normave të interesit (dhe luhatjeve të tyre) në vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshme;
- Perspektiva e të ardhurave neto nga interesi (NII - Të ardhura nga interesi neto) vlerëson ndikimin e lëvizjeve të pafavorshme të normave të interesit (dhe luhatjeve të tyre) në të ardhurat neto nga interesi.

Perspektiva VEK siguron një vlerësim të efektit afatmesëm-afatgjatë të nxitur nga lëvizjet e normave të interesit; ndërsa, perspektiva e NII siguron një vlerësim të efektit afatshkurtër.

i) Analiza e zhvendosjes së ndjeshmërisë (VEK) saktëson ndryshimin në vlerë të portofolit financiar të Intesa Sanpaolo Bank Albania që rezulton nga lëvizjet e pafavorshme të normës së interesit. Një lëvizje e pafavorshme përkufizohet si një zhvendosje paralele dhe uniforme e kurbës së normës së interesit prej  $\pm 100$  pikësh. Ndryshimi në vlerën ekonomike pasqyron ndryshimin në vlerën e të gjitha flukseve të mjeteve monetare të instrumentave në bilanc deri në maturimin e tyre dhe llogaritet si diferencë midis vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të rilogaritura pas një lëvizje të pafavorshme në normat e interesit dhe në vlera aktuale të llogaritura me normat aktuale të interesit.

Kjo matje thekson efektin e variacioneve në normat e interesit të tregut në portofolin që është përllogaritur pa supozuar ndryshime në të ardhmen në aktivet dhe detyrimet e Bankës.

Aktivitetet financiare të Bankës dhe detyrimet e saj kanë normë të ndryshueshme interesi ose kanë një datë rriçmimi në më pak se një vit, me përjashtim të disa letrave më vlerë shqiptare dhe investimeve në letra me vlerë jo shqiptare, të cilat kanë një normë kupon midis 0.9 - 6.9% për letrat me vlerë në USD (2016: 0.9 - 6.9%), nga 0.4 - 5.8% për letrat me vlerë në EURO (2016: 0.5 - 5.8%) dhe nga 0.7 për letrat me vlerë të emetuara në GBP (2016: 1.2 - 2.6%).

Risku i normës së interesit gjeneruar nga aktivet dhe detyrimet e Bankës dhe i matur nëpërmjet analizës së ndjeshmërisë sipas zhvendosjes  $\pm 100$  pikësh, regjistroi në fund të muajit dhjetor 2016 një vlerë prej Lek 710 milion (për +100 pikë) në krahasim me fundin e vitit 2015 (Lek 761 milion). Tabela më poshtë tregon ndarjen sipas monedhave të zhvendosjes së ndjeshmërisë për fund vitin 2016 dhe 2015.

Rregullorja e Bankës për Menaxhimin e Riskut të Interesit, "Udhëzimet e ISBA mbi qeverisjen e IRRBB" dhe "Rregullat ISBA për matjen dhe kontrollin e IRRBB" janë miratuar nga Bordi i Drejtorëve i ISBA më 3 Maj 2017. Dokumentet e përditësuara zbatojnë dispozitat e fundit rregullatore, të përcaktuara së fundmi në Udhëzimet e nxjerra nga Banka Mëmë, bazuar në rregulloren e EBA (maj 2015) dhe pjesërisht duke parashikuar kuadrin rregullator të ofruar nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare (BCBS-Prill 2016) mbi riskun e normave të interesit në librat e bankës i cili do të hyjë në fuqi nga janari i vitit 2018 dhe dispozitat e udhëzimit të Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librat e bankës", miratuar sipas vendimit nr. 33, datë 30 prill 2013. Rreziku i normës interesi i gjeneruar nga aktivet dhe detyrimet e Bankës, të matura nëpërmjet analizës së zhvendosjes së ndjeshmërisë së vlerës së drejtë prej  $\pm 100$  pikësh bazë, të regjistruara në fund të dhjetorit 2017, vlerësohet prej -740 milionë Lek (për + 100 pikë bazë) krahasuar me fundin e vitit 2016 -710 milionë Lek.



## 5. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

### c) Risku i tregut (vazhdim)

#### Ekspozimi ndaj riskut të normës së interesit

Tabela më poshtë tregon ndarjen sipas monedhave të analizës së zhvendosjes së ndjeshmërisë për fundin e vitit 2017 dhe 2016.

Zhvendosja e ndjeshmërisë 31 dhjetor 2017	Rritje në pikë bazë	Totali	Ndjeshmëria e Fitimit & Humbjes	Ndjeshmëria e Kapitalit
EUR	+100 b.p. / -100 b.p.	(204,532)/ 218,611	(156,362)/ 169,155	(48,169)/49,455
USD	+100 b.p. / -100 b.p.	(133,350)/ 147,781	(127,991)/ 142,350	(5,358)/5,431
LEK	+100 b.p. / -100 b.p.	(402,981)/ 421,762	(402,981)/ 421,762	
Të tjera (GBP & CHF)	+100 b.p. / -100 b.p.	567/(412)	970/(615)	(402)/202

Zhvendosja e ndjeshmërisë 31 dhjetor 2016	Rritje në pikë bazë	Totali	Ndjeshmëria e Fitimit & Humbjes	Ndjeshmëria e Kapitalit
EUR	+100 b.p. / -100 b.p.	(222,369)/ 225,848	(192,000)/ 218,504	(30,369)/7,343
USD	+100 b.p. / -100 b.p.	(190,681)/ 211,274	(184,714)/ 205,247	(5,967)/ 6,027
LEK	+100 b.p. / -100 b.p.	(292,471)/ 306,044	(292,471)/ 306,044	
Të tjera (GBP & CHF)	+100 b.p. / -100 b.p.	(4,703)/ 3,358	1,147/(1,571)	(5,849)/ 4,930

Kufizimet në analizën e zhvendosjes së ndjeshmërisë për vlerës e drejtë për një goditje prej + 100bp dhe ndjeshmëria NII për goditjet +/- 50bp janë përfshirë tek limitet e RAF për ISBA 2017.

Kufiri për analizën e zhvendosjes së ndjeshmërisë në valutë të vlerës së drejtë për goditje prej +/- 100 bp është rritur në nivelin EUR +/- 2.8mln (nga EUR +/- 2.6mln).

II) Analiza e zhvendosjes së ndjeshmërisë të të ardhurave neto nga interesi regjistron efektet NII të cilat rezultojnë nga lëvizja e normave të tregut në momentin e rinovimit / ri-çmimit të librit të bankës. Ajo saktëson ndikimin afat-shkurtër në të ardhurat neto nga interesi ndaj një goditje paralele, të menjëhershme dhe të përhershme prej +/- 50 pikë të kurbës së normës së interesit. Kjo masë evidenton efektin e ndryshimeve në normat e tregut në marzhin e interesit i cili gjenerohet nga portofoli që matet, duke përjashtuar efektet e mundshme që rezultojnë nga operacionet e reja dhe ndryshimet në të ardhme të grupit të aktiveve dhe detyrimeve. Kohëzgjatja e referencës zakonisht kufizohet në një vit dhe sipas hipotezës që institucioni është në gjendje të vazhdojë aktivitetet e tij ("parimi i vazhdimësisë").

Risku i normës së interesit gjeneruar nga aktivet dhe detyrimet e Bankës dhe i matur nëpërmjet analizës së ndjeshmërisë sipas zhvendosjes ± 50 pikësh, regjistroi në 31 dhjetor 2017 një vlerë prej 271 milion Lek (për -50 pikë) dhe një vlerë prej -269 milion Lek (për -50 pikë).

Një model i sjelljes paraqitet për qëllimet e ndjeshmërisë së NII, i cili zbatohet për pozicionet e klientëve në lek dhe euro, duke përcaktuar normën e interesit të klientit në afat të gjatë dhe duke përfshirë tiparet e sjelljes dhe reagimin e vonuar ndaj normave të interesit të tregut (në afatshkurtër) që rezultojnë nga modeli. Zbatimi u finalizua në fund të vitit 2017. Modeli i sjelljes është krijuar nga Departamenti i Zyrës Qendrore të Risqeve Financiare dhe Tregut të ISP, bazuar në të dhënat historike të ISBA të përfuara nga struktura e rrezikut lokal.

III) Banka Qendrore i kërkoi Bankës të përdorë një metodë tjetër për të matur riskun e normës së interesit, e cila konsiston në një monitorim tremujor të ekspozimit të riskut të normës së interesit ndaj një goditje paralele prej +/- 200 pikë bazë të kurbës së normës së interesit. Për të gjitha kategoritë financiare të aktiveve dhe pasiveve të ndara sipas një normë fikse ose të luhatshme, vlera e tyre aktuale është llogaritur dhe klasifikuar në 14 shporta kohore. Më pas vlera aktuale totale shumëzohet përkatësisht me kohëzgjatjen e vlerësuar të modifikuar të çdo shporte kohore. Limiti për këtë ekspozim është 20% i kapitalit rregullator të Bankës. Për vitin 2017, Banka ka qenë brenda limitit ku ekspozimi ndaj riskut të normës së interesit më 31 dhjetor 2017 rezultoi 5.5% të kapitalit rregullator të Bankës (31 dhjetor 2016: 2.7%).

Banka ka qenë brenda kufijve në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë dhe rregulloren e brendshme gjatë vitit 2017.

#### 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

##### c) Risku i tregut (vazhdim)

##### (ii) Ekspozimi ndaj riskut të normës së interesit

Tabelat e mëposhtme paraqesin në mënyrë të përmbledhur aktivet dhe detyrimet e Bankës ndaj riskut të normave të interesit fikse dhe të ndryshueshme, siç raportohet në Bankën Mëmë dhe në drejtimin e Bankës. Informacioni nuk është i njëjtë me atë të dhënë nga drejtimi por është rregulluar sipas tabelës më poshtë. Bazuar në drejtimin rregullores së riskut të normave të interesit, secili instrument financiar vendoset në hendekun e rivlerësimit bazuar në flukse monetare kontraktuale të paskontuara ose në datën e riçimitit. Kontratat përfshijnë instrumente ku Banka përcakton saktësisht kur bëhet maturimi ose riçimi i ardhshëm.

31 dhjetor 2017		Pa afat	0-3 muaj	3-18 muaj	18m - 3 vite	3 - 5 vite	>5 vite	Totali
<b>Aktive</b>	<b>Lloji i normave të interesit</b>							
Hua dhe paradhënie bankave	Fikse	12,867,621	22,058,473	6,178,135	-	-	-	41,104,229
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie klientëve	Fikse	16,280,964	918,699	2,637,672	2,617,980	1,524,981	846,001	24,826,297
	Të ndryshueshme	23,327,858	531,684	1,354,486	835,270	648,515	718,502	27,416,315
Investime financiare – Letra me vlerë të vendosjes dhe të investimit	Fikse	-	9,269,812	19,340,583	7,336,175	11,944,592	2,744,323	50,635,485
	Të ndryshueshme	-	5,599,688	6,775,875	125,954	51,337	27,328	12,580,182
Aktive të tjera financiare		-	-	-	-	-	-	-
<b>Aktive financiare gjithsej</b>		<b>52,476,443</b>	<b>38,378,356</b>	<b>36,286,751</b>	<b>10,915,379</b>	<b>14,169,425</b>	<b>4,336,154</b>	<b>156,562,508</b>
<b>Detyrimet</b>								
Detyrime ndaj bankave	Fikse	(55,544)	(3,573,652)	-	(234,050)	-	-	(3,863,246)
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	Fikse	(77,942,515)	(14,819,937)	(29,822,156)	(3,579,196)	(1,584,429)	(689,714)	(128,437,947)
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera		-	-	-	-	-	-	-
<b>Detyrime financiare gjithsej</b>		<b>(77,998,059)</b>	<b>(18,393,589)</b>	<b>(29,822,156)</b>	<b>(3,813,246)</b>	<b>(1,584,429)</b>	<b>(689,714)</b>	<b>(132,301,193)</b>
<b>Pozicioni neto i ndjeshmërisë së interesit</b>		<b>(25,521,616)</b>	<b>19,984,767</b>	<b>6,464,595</b>	<b>7,102,133</b>	<b>12,584,996</b>	<b>3,646,440</b>	<b>24,261,315</b>

Sjellja përfshin instrumente që nuk janë të përshtatshme, që jeta e mbetur dhe/ose norma e interesit kanë nivele të larta të pasigurisë që mund të ndikohen nga sjelljet specifike të klientëve, si huatë (paradhëniet ndaj bankave dhe paradhëniet ndaj klientëve) dhe depozitat me afat (llogaritë rrjedhëse për klientët ) janë pozicionuar në kategorinë pa afat, deri në përcaktimin e koeficientëve të sjelljes.

Pozicioni neto i ndjeshmërisë së interesit llogaritet sipas rregullave të brendshme mbi rrezikun e normës së interesit dhe si diferencë midis aktiveve që mbartin interesa dhe detyrimeve që mbartin interes në një klasifikim kohor të dhënë. Aktivitet/detyrimet e tjera financiare, kapitali dhe rezervat, janë zëra që nuk përfshihen në pozicionin neto të ndjeshmërisë së interesit duke mos u konsideruar si zëra që mbartin interesa.

**5. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)****c) Risku i tregut (vazhdim)****Ekspozimi ndaj riskut te normës se interesit**

31 dhjetor 2016		Pa afat	0-3 muaj	3-18 muaj	18m - 3 vite	3 - 5 vite	>5 vite	Totali
<b>Aktive</b>	<b>Lloji i normave të interesit</b>							
Hua dhe paradhënie bankave	Fikse	14,392,651	23,191,077	5,628,130	-	-	-	43,211,858
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie klientëve	Fikse	14,441,060	239,215	2,511,475	1,747,695	1,765,700	907,058	21,612,203
	Të ndryshueshme	20,890,842	1,055,902	1,258,263	764,159	577,568	460,825	25,007,559
Investime financiare – Letra me vlerë të vendosjes dhe të investimit	Fikse	-	6,301,061	18,974,143	5,843,442	7,432,874	3,420,119	41,971,639
	Të ndryshueshme	-	2,538,276	17,465,357	225,585	75,299	39,419	20,343,936
Aktive të tjera financiare		-	-	-	-	-	-	-
<b>Aktive financiare gjithsej</b>		<b>49,724,553</b>	<b>33,325,531</b>	<b>45,837,368</b>	<b>8,580,881</b>	<b>9,851,441</b>	<b>4827421</b>	<b>152,147,195</b>
<b>Detyrimet</b>								
Detyrime ndaj bankave	Fikse	(964,053)	(1,886,323)	-	-	-	-	(2,850,376)
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	Fikse	(71,949,704)	(15,999,004)	(32,763,905)	(5,885,522)	(25,755)	(29,531)	(126,653,421)
	Të ndryshueshme	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera		-	-	-	-	-	-	-
<b>Detyrime financiare gjithsej</b>		<b>(72,913,757)</b>	<b>(17,885,327)</b>	<b>(32,763,905)</b>	<b>(5,885,522)</b>	<b>(25,755)</b>	<b>(29,531)</b>	<b>(129,503,797)</b>
<b>Pozicioni neto i ndjeshmërisë së interesit</b>		<b>(23,189,204)</b>	<b>15,440,204</b>	<b>13,073,463</b>	<b>2,695,359</b>	<b>9,825,686</b>	<b>4,797,890</b>	<b>22,643,398</b>

## 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

### d) Risku operacional

Risku operacional përkufizohet si rreziku i humbjes që rezulton nga procese të brendshme të papërshtatshme ose jo funksionale, mos-veprimi ose veprimi i papërshtatshëm i punonjësve, mos-funksionimi i sistemeve ose ngjarje të jashtme. Ky përkufizim përfshin rrezikun ligjor, ose rrezikun e humbjeve që rezulton nga shkelja dhe mos-repspektimi i ligjit ose rregulloreve, nga detyrimet kontraktuale ose konstruktive ose nga mosmarrëveshje të tjera; rrezikun e modelit, i cili përkufizohet si humbja e mundshme që pëson një subjekt, si rezultat i vendimeve të cilat bazohen kryesisht në rezultatet e modeleve të brendshme, që janë shkaktuar gjatë zhvillimit, implementimit ose përdorimit të tyre; rrezikun e përputhshmërisë rregullative, i cili përkufizohet si rreziku për të qenë subjekt i penaliteteve gjyqësore ose administrative, humbjet financiare të konsiderueshme të cilat rezultojnë nga shkelja e rregulloreve të detyrueshme ose rregullave të vetë bankës; rrezikun TIK (Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit, ose thjesht rreziku kompjuterik) i cili përkufizohet si risku për të pësuar humbje ekonomike në lidhje me përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Rreziku strategjik dhe reputacional nuk janë përfshirë.

Këshilli Drejtuesi i Bankës ka miratuar udhëzimet e kuadrit të përgjithshëm për administrimin e riskut operacional së bashku me politikën dhe procesin organizativ për matjen, administrimin dhe kontrollin e riskut operacional. Rregullorja e Bankës mbi Udhëzimet për Administrimin e Riskut Operacional është në përputhje të plotë me Udhëzimet e Grupit për Administrimin e Riskut Operacional, miratuar në dhjetor 2014.

Komiteti i Administrimit të Riskut Operacional të Bankës (këtu dhe më poshtë referuar ORCO) është përgjegjëse administrimin e riskut operacional të bankës në lidhje me rishikimin e dokumentacionit të administrimit të riskut operacional dhe miratimit të ndryshimeve, përgatitjes së politikave, standardeve dhe metodologjive për administrimin e riskut operacional. Një nga instrumentet që aplikohet për administrimin e riskut operacional është përcaktimi i Treguesve Kryesor të Riskut Operacional (KRI). Zyra e Riskut të Tregut dhe Operacional në bashkëpunim me përgjegjësit e njësive të biznesit kanë përcaktuar në Bankë 15 Tregues Kryesor të Riskut, të cilët janë matur dhe monitoruar për 6 muaj për çdo muaj. Në bazë të të dhënave statistikore të periudhës së monitorimit të matjes, në tetor 2015 Komiteti i Riskut Operacional të ISBA-s miratoi listën përfundimtare të Treguesve Kryesor të Riskut dhe limitet. Nga momenti i miratimit të tyre, Treguesit Kryesor të Brendshëm janë monitoruar dhe raportuar çdo tremujor në mbledhjet e Komitetit të Riskut Operacional. Treguesit e brendshëm KRI rishikohen çdo vit për të siguruar pajtueshmërinë e tyre me dinamikën e kuadrit operacional dhe rreziqet e rëndësishme me të cilat përballet Banka. Çdo ndryshim në politikën për Treguesit Kryesor të Riskut miratohet në Komitetin e Riskut Operacional dhe Këshillin Drejtues.

Divizioni i Administrimit të Riskut të Kredisë është përgjegjës për identifikimin, vlerësimin, administrimin dhe zbutjen e rreziqeve operacionale, verifikimin e efikasitetit të zbutjes si dhe për raportimin tek Drejtimi i Lartë i Bankës dhe Administrimin e Riskut të Grupit me qëllimin për të vlerësuar ndikimin e mundshëm ekonomik të ngjarjeve operacionale veçanërisht të rënda.

Banka realizon një fushatë vlerësimi vjetor të projektuar nga Grupi Intesa Sanpaolo dhe procesin e vetë-vlerësimit, të cilat kanë në fokus identifikimin dhe vlerësimin e riskut operacional që lidhet me aktivitetin e çdo njësie të vetme brenda një strukture.

Objektivat e procesit të vetë-vlerësimit janë të identifikojë, mat, monitorojë dhe zbut rreziqet operacionale. Procesi i vetë-vlerësimit kontribuon në përhapjen e kulturës së kontrollit të riskut në Bankë. Ky proces përbëhet nga faza të caktuara të cilat lidhen me vlerësimin e mjedisit të biznesit, që përcakton cilësinë e profilit të kontrollit të riskut të çdo strukture nëpërmjet analizës së rëndësishme dhe nivelit të administrimit e faktorëve të riskut në kontekstin dhe fazat operacionale në lidhje me analizën e skenarit, e cila përcakton madhësinë e profilit të riskut të çdo strukture duke mbledhur të dhënat sasiore të përlllogaritura nga Njësitë përgjegjëse të biznesit dhe operacionale.

Në bazë të rregullores për administrimin e riskut operacional, e cila ka hyrë në fuqi në janar 2011, Banka ka të njëjtat përgjegjësi ndaj Bankës së Shqipërisë. Banka raporton rregullisht për treguesit kryesor dhe klasifikimin e humbjeve operacionale efektive sipas linjave të biznesit bazuar mbi kërkesat rregullatore.

#### 4. Administrimi i Riskut Financiar (vazhdim)

##### e) Administrimi i kapitalit

Rregullatori kryesor i Bankës, Banka Qendrore, vendos dhe monitoron kërkesën për kapital të Bankës. Politika e Bankës është të mbaje bazën e kapitalit brenda limiteve, duke kapitalizuar të gjitha të ardhurat nga aktiviteti në mënyrë që të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit duke njohur impaktin aktual të nivelit të kapitalit mbi kthimet ndaj aksionereve. Banka njih nevojën për të mbajtur një ekuilibër midis kthimeve me të larta që mund të jenë të mundura duke përdorur me shume instrumente dhe avantazhe që ofrohen nga një pozicion i fortë i kapitalit.

Nëpërmjet zbatimit të kërkesave aktuale për kapitalin, Banka e Shqipërisë i kërkon Bankës të ruaj raportin e vendosur të kërkesave aktuale për kapital ndaj totalit të aktiveve të ponderuara me risk dhe zërave jashtë bilancit në nivelin minimal të 12%. Gjatë vitit ushtrimor 2017, raporti i mjaftueshmërisë së Bankës rezultoi mbi nivelin minimal të kërkuar, i cili më 31 dhjetor 2017 rezulton 18.91% (2016: 17.57%).

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit i ndryshuar, i cili përfaqëson raportin e kapitalit bazë ndaj aktiveve të ponderuara me risk dhe zërat jashtë bilancit, është një limit tjetër prej 6% që ka vendosur Banka e Shqipërisë.

Gjatë gjithë periudhës nuk kanë rezultuar ndryshime materiale në administrimin e kapitalit të bankës dhe janë respektuar të gjitha kërkesat rregullatore për kapital.

Rregullorja e re për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (RMK) miratuar në Mars 2015 bazohet në kriteret e Bazel II dhe është në përputhje me Direktivat Europiane për Institucionet Financiare. Megjithëse në bazë të rregullores së re dhe masave kundërciklike rrisin nivelin e aktiveve të ponderuara me risk, Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të Bankës vazhdoi të jetë mbi nivelin minimal të kërkuar përgjatë vitit 2017.

	Shënim	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kapitali bazë			
Kapitali aksioner	21	5,562,518	5,562,518
Primi i aksioneve	21	1,383,880	1,383,880
Rezerva ligjore dhe rregullative	22	1,825,623	1,825,623
Fitimi i pashpërndarë		7,059,651	6,419,968
		15,831,672	15,191,989
<b>Zbritjet:</b>			
Aktive jo-materiale rregullative		(619,181)	(692,374)
		<b>15,212,491</b>	<b>14,499,615</b>
<b>Totali i kapitalit bazë kualifikues</b>			
Aktive të ponderuara me risk:			
Në bilanc		70,887,267	72,470,562
Aktive me risk për riskun operacional		9,572,263	10,032,850
<b>Totali i aktiveve të ponderuara me risk</b>		<b>80,459,530</b>	<b>82,503,412</b>
<b>Raporti i kapitalit bazë ndaj aktiveve të ponderuara me risk</b>		<b>18.91%</b>	<b>17.57%</b>

## 5. Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykimet, çmuarjet dhe supozimet të cilat prekin zbatimin e politikave kontabël dhe vlerat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto çmuarje.

Çmuarjet dhe supozimet në fjalë rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën gjatë të cilës rishikohen çmuarjet si dhe në periudha pasardhëse që ndikohen.

Drejtimi diskuton me Drejtimin e Grupit zhvillimin, përzgjedhjen dhe prezantimin e politikave të rëndësishme kontabël dhe zbatimin e tyre, si dhe supozimet e bëra në lidhje me pasiguritë kryesore të çmuarjeve. Informacioni në lidhje me supozimet dhe pasiguritë e çmuarjeve të cilat kanë një risk të konsiderueshëm të cilat sjellin një rregullim material brenda periudhës financiare të radhës dhe rreth gjykimeve të rëndësishme për zbatimin e politikave kontabël të cilat kanë efektin më të madh tek shumat e njohura në pasqyrat financiare paraqitet më poshtë. Këto shënime plotësojnë komentet për administrimin e rrezikut financiar (shikoni shënimin 4).

### (a) Humbjet nga zhvlerësimet për huatë dhe paradhëniet

Banka rishikon dhe analizon huatë dhe paradhëniet individualisht të rëndësishme në çdo datë të hartimit të pasqyrës së gjendjes financiare për të vlerësuar nëse humbjet nga zhvlerësimi duhet të regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave. Në mënyrë të veçantë, gjykimi nga drejtimi është i nevojshëm për vlerësimin e shumës dhe kohën e rrjedhjes së ardhshme të parasë kur përcaktohen humbjet nga zhvlerësimi. Në përlogaritjen e fluksit të parasë, banka gjykon situatën financiare të huamarrësit dhe vlerën neto të realizueshme të kolateralit. Këto çmuarje bazohen në supozime lidhur me disa faktorë dhe rezultatet aktuale mund të ndryshojnë, duke sjelle ndryshime të ardhshme në zbritjet nga huatë. Huatë dhe paradhëniet e vlerësuara në mënyrë individuale dhe që kanë rezultuar të pazhvlerësueshme, si dhe të gjitha huatë dhe paradhëniet individuale jo të konsiderueshme vlerësohen kolektivisht, në grupe aktivesh me karakteristika të ngjashme risku, për të përcaktuar nëse duhen krijuar provigjione për shkak të ngjarjeve të humbjeve për të cilat ekziston prove evidente, por efektet ende nuk janë të dukshme. Vlerësimi kolektiv merr në konsideratë të dhënat nga portofoli i huave (si cilësia e kredisë, ditët e vonesave, përdorimi i kredisë, etj.) dhe përqendrimet e tjera të riskut dhe të dhënave ekonomike. Humbjet nga zhvlerësimi për huatë dhe paradhëniet paraqiten në mënyrë të detajuar në shënimin 11.

### (b) Vlera neto e realizueshme e inventarit

Banka ka miratuar një politikë në lidhje me vlerat e drejta të aktiveve të marra në pronësi të cilat maten me një kosto më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Matja e vlerës së drejtë përfshin përdorimin e vlerave të jashtme dhe të pavarura të pronës, të cilat plotësojnë kualifikimet e duhura statutores të pranuar, dhe më pas janë subjekt i rishikimit nga Drejtimi i Bankës për të dhëna të rëndësishme të panjohura dhe çdo rregullim të nevojshëm për reduktimin e vlerës.

### (c) Investimet në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Banka ndjek dhe zbaton udhëzimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit SNK 39, Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja e klasifikimit të aktiveve financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturim të pandryshueshëm si letra me vlerë të mbajtura deri në maturim. Ky klasifikim kërkon çmuarje të rëndësishme. Për çmuarjet, banka vlerëson qëllimin dhe mundësinë e saj për të ruajtur këto investime deri në maturim.

### (d) Përcaktimi i kontrollit ndaj investuesve

Drejtimi i Bankës përdor çmuarjet e tij për të përcaktuar nëse Banka kontrollon investuesit. Për të vlerësuar nëse Banka kontrollon investuesit, Banka kryen analizën e fuqisë së investuesve dhe merr në konsideratë qëllimin dhe strukturën e investuesit, provat e mundësisë praktike për të drejtuar aktivitetet përkatëse të investuesit, etj.

Si rezultat, Banka arriti në përfundimin se nuk kontrollon dhe për rrjedhojë nuk duhet të konsolidojë mjetet me qëllim të veçantë dhe subjektet me të ardhura të përcaktuara, pasi Banka nuk ushtron asnjë kompetencë ndaj aktiviteteve përkatëse të këtyre subjekteve.

## 5. Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël (vazhdim)

### (e) Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Në rastet kur vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare, e regjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar, nuk mund të përfitohet nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur disa teknika të ndryshme vlerësimi të cilat përfshijnë dhe përdorimin e modeleve matematikore. Të dhënat që përdoren në këto modele janë të dhënat që vëzhgohen në treg, dhe kur këto të dhëna nuk janë të disponueshme, nëpërmjet gjykimit përcaktohen vlerat e drejta. Për instrumentet financiare që nuk tregtohen shpesh dhe kanë transparence të kufizuar për çmimin, vlera e drejtë është më pak objektive dhe nevojiten nivele të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozime çmimi dhe risqe të tjera që prekin instrumentin e caktuar. Vlerësimi i instrumenteve financiare paraqitet në mënyrë të detajuar në shënimin 6. Banka përdor hierarkinë e mëposhtme për përcaktimin dhe pasqyrimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare nëpërmjet teknikes së vlerësimit:

Niveli 1: çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për aktive dhe pasive identike;

Niveli 2: teknika të tjera, për të cilat të gjitha të dhënat që kanë një impakt të konsiderueshëm në vlerën e drejtë të regjistruar, janë të vëzhgueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo; dhe

Niveli 3: teknikat që përdorin të dhëna të cilat kanë një impakt të konsiderueshëm në vlerën e drejtë të regjistruar, të cilat nuk bazohen në të dhënat e vëzhgueshme të tregut.

Analiza e instrumenteve financiare të regjistruar me vlerën e drejtë sipas hierarkisë paraqitet si më poshtë vijon:

31 dhjetor 2017	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
<b>Investime financiare-Letra me vlerë të vendosjes</b>				
Investime të kuotuar				
Letra me vlerë të borxhit të qeverisë	4,764,697	-	2,140,949	<b>6,905,646</b>
Letra të tjera me vlerë të borxhit	1,665,258	345,355	-	<b>2,010,613</b>
Investime të pakotuara	-	-	506,749	<b>506,749</b>
<b>Totali</b>	<b>6,429,955</b>	<b>345,355</b>	<b>2,647,698</b>	<b>9,423,008</b>

  

31 dhjetor 2016	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
<b>Investime financiare-Letra me vlerë të vendosjes</b>				
Investime të kuotuar				
Letra me vlerë të borxhit të qeverisë	4,099,821	-	-	<b>4,099,821</b>
Letra të tjera me vlerë të borxhit	2,426,419	-	-	<b>2,426,419</b>
Investime të pakotuara	-	-	725,208	<b>725,208</b>
<b>Totali</b>	<b>6,526,240</b>	<b>-</b>	<b>725,208</b>	<b>7,251,448</b>

Gjatë vitit ushtrimor nuk ka rezultuar asnjë transfertë midis kategorive, pasi nuk ka patur asnjë ndryshim në metodologjinë e përdorur për përcaktimin e niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë dhe as ndryshim në aktivitetet e tregut të instrumenteve financiare.

### (f) Të drejta tatimore të shtyra

Të drejtat tatimore të shtyra të cilat rezultojnë nga humbjet nga tatimet dhe diferencat e përkohshme, njihen si aktive nëse ekzistojnë gjasat që fitimi i tatuueshëm në të ardhmen do të jetë i mjaftueshëm për të lejuar përfitimin nga humbjet që të realizohet. Gjykimi është i nevojshëm për të përcaktuar shumën e të drejtave tatimore të shtyra që mund të njihet, në bazë të kohës dhe nivelit të ardhshëm të fitimit të tatuueshëm dhe strategjive të ardhshme të planifikimit tatimor. Për më shumë detaje referojuni shënimin 3 (f) dhe 18.

### (g) Risku i çështjeve ligjore

Drejtimi i bankës ka krijuar procesin e brendshëm në lidhje me njohjen dhe matjen e provizioneve dhe detyrimeve të kushtëzuara si rezultat i çështjeve ligjore aktuale ose në të ardhmen. Supozimet kryesore mbi gjasat dhe madhësinë e një fluksi në dalje të burimeve bazohen në konsulencën ligjore të brendshme dhe të jashtme sipas strategjive përkatëse të suksesshme të mbrojtjes përkundrejt masave dhe veprimeve që rezultojnë. Çdo masë dhe risku përkatës vlerësohet sipas meritave dhe detyrimit në fjalë konstruktiv ose ligjor dhe çmuarjes së fluksit të parasë në dalje të cilat vlerësohen të pagueshme, miratohet në mënyrë të pavarur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Bankës. Drejtimi i Bankës beson se çështjet ligjore ekzistuese ose të mundshme në të ardhmen kanë pak gjasa për të ndodhur, megjithatë për shkaqe që shkojnë përtej kuadrit ligjor, banka mund të përballet me risqe të tjera.

## 6. Aktivet dhe Detyrimet Financiare

Klasifikimi kontabël dhe vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare të cilat nuk mbarten me vlerën e drejtë:

Shënimi	Vlera kontabël				Vlera e drejtë				
	Letra me vlerë të investimit	Hua dhe paradhënie bankave	Detyrime të tjera financiare	Totali i vlerës kontabël	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali	
<b>31 dhjetor 2017</b>									
Hua dhe paradhënie bankave	7	-	20,171,066	-	20,171,066	-	-	20,171,066	<b>20,171,066</b>
Investime në letra me vlerë deri ne maturim	10	49,110,119	-	-	49,110,119	4,691,391	-	45,628,746	<b>50,320,137</b>
<b>Totali</b>		<b>49,110,119</b>	<b>20,171,066</b>	-	<b>69,281,185</b>	<b>4,691,391</b>	-	<b>65,799,812</b>	<b>70,491,203</b>
Depozita nga klienti	16	-	-	127,711,325	127,711,325	-	-	-	<b>128,077,040</b>
<b>Totali</b>		-	-	<b>127,711,325</b>	<b>127,711,325</b>	-	-	-	<b>128,077,040</b>

Shënimi	Vlera kontabël				Vlera e drejtë				
	Letra me vlerë të investimit	Hua dhe paradhënie bankave	Detyrime të tjera financiare	Totali i vlerës kontabël	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali	
<b>31 dhjetor 2016</b>									
Hua dhe paradhënie bankave	7	-	17,106,968	-	17,106,968	-	-	17,106,968	17,106,968
Investime në letra me vlerë deri ne maturim	10	50,729,433	-	-	50,729,433	4,666,485	404,875	46,695,062	51,766,422
<b>Totali</b>		<b>50,729,433</b>	<b>17,106,968</b>	-	<b>67,836,401</b>	<b>4,666,485</b>	<b>404,875</b>	<b>63,802,030</b>	<b>68,873,390</b>
Depozita nga klienti	16	-	-	125,974,220	125,974,220	-	-	-	126,033,512
<b>Totali</b>		-	-	<b>125,974,220</b>	<b>125,974,220</b>	-	-	-	<b>126,033,512</b>

Letrat me vlerë të investimit të Qeverisë Shqiptare janë fikse dhe me bono normë të ndryshueshme. Letrat me norma të luhatshme paraqiten si rendiment mesatar i tre ankandeve të fundit të bonove të thesarit me maturim një vjeçar plus spread. Matja e vlerës së drejtë për këto letra me vlerë kryhet duke përdorur metodën e vlerësimit të tregut, duke i zbritur të gjitha flukset monetare të ardhshme që rrjedhin nga këto instrumente. Pjesa tjetër e letrave me vlerë të huaj të investimit të shprehur në valutë të huaj përfaqëson letrat me vlerë të Bankës dhe të Institucioneve Financiare, vlera e drejtë e të cilëve matet sipas "rregullave të brendshme të vlerës së drejtë të ISBA".

Huatë dhe paradhëniet për klientët mbahen me vlerën kontabël, e cila konsiderohet edhe si vlera e tyre e drejtë, pasi pjesa më e madhe e portofolit bazohet në normat e interesit të ndryshueshme. Vlera e drejtë e depozitave me afat nga klientët riçmohet duke përdorur vlerën aktuale neto. Normat e interesit e aplikuar janë normat e interesit të tregut të publikuara nga Banka Qendrore e Shqipërisë. Këto norma janë një vlerësim i normave të tregut. Vlera e drejtë e llogarive rrjedhëse dhe llogarive të kursimit konsiderohet e përafërt me vlerën e tyre kontabël, duke pasur parasysh që kanë maturitet afatshkurtër.



## 7. Mjete monetare dhe të ngjashme

Mjetet monetare dhe të ngjashme për periudhat 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten në mënyrë të detajuar si më poshtë:

